

# MARDHENIET

## TURKO - GREKE

### DHE BALLKANI

(NJE VLERESIM HISTORIK I PROBLEMEVE TE SOTME)



**Dr. M. Cosmas MEGALOMMATIS**

FONDACIONI QIPRIOT

## H Y R J E

Ky liber permban dy pjese; ne pjesen e pare, eshte analizuuar qendrimi anti Turk ne Greqi. Si nje orientalist dhe si historian, autori ka bere vleresimet e tij mbi shtetin dhe shoqerine Greke te cilet po formojne qendrimin e kesaj shoqerie dhe zbatimin e politikës ndaj Turqise. Si nje orientalist, Dr. Muhammad Cosmas Megalommatis e njeh shoqerine Turke shume mire. Ai ka shkruar libra dhe artikuj te veçante rreth historise, arkeologjise dhe aspekteve politike te Turqise dhe fqinjëve te saj. Ai ka bere edhe vleresime te shquara mbi establishmentin dhe shoqerine Greke.

Ne pjesen e dyte te ketij libri jane analizuar thelleshmardhenjet e Greqise me vendet Ballkanike. Vrojtimit historike dhe vleresimet e autorit jane shprehur me kujdes dhe ne baze te grumbullimit te pervojës se tij akademike.

Ne veçanti, vrojtimit kritike dhe vleresimet rreth qeshtjeve qe shqetesojne Ballkanin dhe mardhenjet Greko - Turke, jane pare nga nje pike veshtrimi gjeresisht intelektuale e studimore. Ky liber do te permbushe nje zbraztesi ne njohjen e problemeve te mardhenjeve Greko - Turke si dhe mbi mardhenjet e Greqise me vendet tjera te Ballkanit.

Fondacioni Qipriot.

## P J E S A E P A R E

### MARDHENJET GREKO - TURKE

#### 1.- RRENJET E QENDRIMIT ANTI - TURK NE TE SHTETIT DHE SHOQERISE GREKE:

Qendrimi qe qytetaret e nje vendi mbajne ndaj atyre te nje vendi tjetër, përveç tjerash është i lidhur me formimin e këtyre qytatave në përmjet të sistemit arsimor dhe sistemit të vlerave sociale të vendit të vet. Për të kuptuar qendrimin anti - Turk të Greqisë është e nevojshme të verëhet se çfare mesojne Greket në shkollat fillore e të mesme, pastaj si këta elemente të edukimit përhapen në rrangun e universitetit, të mas medias, librave dhe të diskutimeve politike. Është gjithashtu esenciale të dijmë se të gjithë mesojne të njëjtat gjera. Në shkollat e shtetit edhe në ato private, fillore apo të mesme qofshin, librat janë të njëjtë.

Para se gjithash në Greqi bëhet një kurs fetar i cili nuk ka asgjë të bëjë me atë çfare konsiderohet në botë si histori e fese, pasi që faja që mesojne Greket është ajo e pikpamjes së Kristianizmit Ortodoks për Kristianizmin i cili është krejtësisht kontradiktore me rezultatet e shkollave moderne dhe shkencës. E gjitha kjo ndihmon për të marrë një idë rreth Kristianizmit çka është gjithashtu jo reale.

Ateherë çështja vazhdon me atë se çfare është quajtur literature e kursit. Në këto kurse pjesët nga literatura Greke janë zgjedhur në një mënyrë të tillë që të bëjë greket të pranojnë idetë ortodokse të gjendjes sociale. Kështu nëpërmjet të këtyre kurseve letrare, Greket fillojnë të formojnë karakterin tyre sipas interesave të Kishës Ortodokse. Ata janë formuar jo vetëm prej kurseve të fese, por edhe prej të gjitha llojeve të tjera të kurseve duke i përshatur ato me idetë e Kishës Ortodokse.

Sigurisht që ka edhe kurse të tjera, përfshirë historinë, filozofinë, por të gjitha kurset nuk kanë aspak të bëjnë me atë se çfare pranonet si nivel nderkombëtar i universiteteve dhe qendrave kërkimore nëpërmjet, por çdo gjë është e lidhur me idetë kristiane ortodokse rreth subjektit të mesuar.

Në të vërtetë, nuk është kulture Greke, por kulture dhe edukate Ortodokse ajo që u jepet Grekëve të nivelit të mesëm. Kjo i bën Greket të

kene jo karakter Evropian por karakter fetar.

Kjo tregon me se miri se çfare eshte vete shteti Grek: Ai eshte nje shtet fetar, jo laik nderkohe qe vete Kushtetuta Greke fillon me fjalët: **"Ne emer te Babes, Djalit dhe Shpirtit te Shenjte"**. Nga ana tjeter festat kombetare nuk festohen ne Parlament ose vende historike (monumente) por neper kisha. Deputetet e marrin detyren ne Parlament prej prifterinjeve te cilet jane te pranishem ne inagurimin e sesionit Parlamentar.

Te gjitha manifestimet e kesaj ideologjie kryhen edhe ne nivele universitare. Prandaj universitetet nuk jane ne ate udhe qe jane universitetet ne Evrope e Amerike. Ne universitetet Greke mesohen vetem pese pergjint e ndoshta edhe me pak e atyre lendeve qe ne bote mesohen si shkenca humane. Kjo do te thote se vetem studimet per Greket, Englezet, Francezet, Gjermanet dhe Italianet pranohen ne nivelet e diplomimit.

Ne Greqi nuk ka kurse per shkallet e Mjeshtrese, ndersa pergatitja e nje grade shkencore (Ph.D.) ne te gjitha subjektet e siperpermendura arrihet pa kerkime shkencore, vetem ne bashkepunim me nje profesor i cili mund te deshiroje qe te ndihmoje e te nxise drejt pozites se nje lektori ne vitet e mepastajme. Merret me mend se sa mund te dine ata qe mbarojne universitetin per subjekte te tilla si bje fjala, qyteterimin Egjyptian Asirian, Babilonas, Hit e per me teper per letersine Arabe, Perse, Spanjolle, Ruse apo Turke. Te gjitha keto e komplikojne edhe me shume çeshtjen. Pasi te jete kompletuar me te gjitha keto, ne fillim ne shkollen fillore e te mesme e pastaj ne universitet, studentit Grek i perjetesohet idea fallse e dogmes historike per nje bote te pergendruar rreth Greqise, Greqise se lashte, e cila u be kristiane; por kjo eshte e gjitha nje genjeshter.

Greket u bene qytetare te Perandorise Romake dhe ata u kristianizuan jo si Greke por si Romake. Ky eshte nje fakt krejt i panjohur ne Greqi. Por edhe kjo ka aresyet e veta pasi duhet mbajtur si fakt i panjohur.

Kjo ndodh per faktin se perhapja e idese se vazhdimesise se te ash tuqajturit komb Grek eshte nje nevojë. Vazhdimesia historike supozohet te ekzistojte qe nga Greket e lashte tek ata Bizantine dhe Greket e sotshem. E dhe kjo s`ka aspak te beje me te verteten.

E verteta eshte se Greket nuk kane patur nje sistem ose ideal politik ta ngjashem me ate qe kishin Iranianet ne kohen e Perandorise se Sasanidit e keshtu ata u bene lehtesisht "qytetare te Perandorise Romake" e me vone si "Romake" u kristianizuan.

Pervec kesaj emri i shtetit ne te cilin jetonin Greqisht - folesit gjate Mesjetes nuk ishte "Perandoria Bizantine", krejt ndryshe nga ajo

çfare thuhet ne historine e fabrikuar Greke. Shteti kishte emrin e Perando rise Romake Lindore. Ne se ndonjeri qe fliste Greqisht ne Perandorine Roma ke te Lindjes e therriste tjetrin Greqisht, "Ellinas", "Grek" ne Greqisht kjo ishte nje fyerje e tmerrshme sepse emri etnik dhe nacional i Grekerve gjate Mesjetes ishte njesoj me fjalen "I d o l a t r o u s"

Ne kete rast , kjo na ndihmon te kuptojme, ashtu sikunder mesohet ne te gjitha universitetet e botes, se nuk ka vazhdimesi nga "Greket e lashte" tek ata te "Greqisht - folesit Romake te Mesjetes" e aq me pak tek "Greket moderne". E te gjitha keto gjera nuk behen te njohura ne Greqi.

Greket mendojne, duke u mbeshtetur tek dijenite qe kane marre ne shkollat e tyre se ata ishin qendra e botes, se qyteterimi fillon ne Greqi dhe se "Greket moderne" ishin nje vazhdimesi e "Grekerve ta lashte".

Mentaliteti i popullit Grek eshte ai, qe çdo njeri mund te shkrua je çfare atij i Pelqen. Kjo eshte sigurisht krejt e pranueshme ne nje vend demokratik, si ne ShBA, Evrope dhe ne te gjitha shoqerite e tjera demokra tike ne bote me nje dallim te dukshem qe ne Evrope dhe Amerike askush nuk shkruan dhe boton çfare ai deshiron, gje qe eshte krejt e pakuptueshme ne Greqi.

Ne Greqi gjenden njerez te cilet kurre nuk kane marre nje diplome te shkolles se larte dhe pranohen si "historiane", prandaj edhe rezultatet e tyre dihen qekurse ata s`kane lexuar kurre ndonje bibliografi ne gjuhe te huaj dhe s`kane njohur kurre diçka tjeter perveçse ideologjise se tyre shteterore pra ky rezultat eshte nje "dogme historike e genjeshtert", cent rizmi Grek i cili eshte i pranishem ne çdo liber te botuar ne Greqi rreth çeshtjeve historike.

Kur e gjithë kultura, aresimi, dhe doktrinimi eshte shprehur ne nivelin e ideve politike, ai zbulon fytyren e tij te vertete e cila eshte raciste. Eshte racist sepse konsideron popujt tjere si armiq, si te paren desishem, ordinere ose barabare, e gjitha kjo po ti referohemi bibliografi se "historike" Greke. Kjo eshte edhe aresyeja e qendrimit te Grekerve ndaj Shqipetareve, Magedoneve, Turqve dhe Muslimaneve.

Ne kete aspekt nje karahasim midis asaj qe mesohet ne Greqi me ate çfare mesohet ne Itali do te ndihmonte shume. Dihet qe gjuha italiane eshte vazhdim i asaj Latine dhe jo fabrikim i disa studjuesve te shekullit te 17 - te e 18 - te. Por kjo kurre nuk i shtyu intelektualet apo studju esit e atij vendi drejt nje Italo centrizmi, ose tek ndonje ide e vijuesh

merise historike. Nga ky krahasim mund te shihet qarte se sa Evropian eshte te edukimi Italian dhe se sa jo - Evropian eshte ai Grek.

## 2. MENTALITETI SOCIAL DHE INTELEKTUAL GREK DHE NDIKIMI I TIJ NE POLITIKEN E JASHTME DHE MARDHENJET NDERKOMBETARE.

Zhan Pol Sartri ka thene se borgjezi prej te qenit borgjez eshte gjithashtu viktime e kapitalizmit. Keshtu administrata Greke, prej te qenit çfare ajo eshte, eshte vete rezultat i asaj injorance, i asaj mungese te dijenive, i mospranimit te idealeve te te tjereve. Ky eshte nje lloj i rrethit vicioz i cili riprodhohet. Greket nuk kane ndonje mjeshtri ne idealet dhe burimet e tyre. Ata mund te konsiderohen si kukulla te nje sistemi apo roboti.

Megjithate, situata ka dinamiken e vet, nje **dinamike raciste** e cila shkakton destabilizim ne Ballkan per shkak te qenjes se Greqise pjese e ketij Gadishulli. Greqia eshte vend fqinje me Shqiperine, Maqedonine, Bullgarine, Turqine. Tek mardhenjet e Greqise me keto vende vertetohen pasojat e mesimit te genjeshtrave, ideve fallse dhe dogmave te genjeshterta historike ne sistemin edukativ Grek.

Per shembull, ne mardhenjet me Shqiperine idea Greke eshte se Shqiperia ishte nje pjese e Greqise se lashte. Çdokush e di se ne ate kohe Shqiperia quhej Iliri dhe Iliret s`kishin aspak te benin me Greket antike. E megjithate kjo s`merr asnje rendesi as per Greket e zakonshem, as per "intelektualet" as per politikenet e as per diplomatet.

E njejta gje thuhet per stergjysherit e Maqedoneve, gje qe gjithashtu s`eshte e vertete. Ne e dime shume mire se Maqedonet e lashte nuk ngjishnin me asnje popull tjetër. Vete fjala "Maqedoni" nuk eshte fjale Greke siç e paraqesin Greket. Ajo vjen me teper si fjale Asiriane e nderkombetarizuar "**Makut Dunu**" e cila do te thote "**nje kamp i fuqishem ushtarak**" ose "**dhunti**".

Gjuha Asiriane u perhap ne Anatoli per shkak te Hiteve, Fyrigianeve (Phrygians) te cilet ishin ne kontakt me vendin e Maqedonise se sotshme dhe Dardanet te cilet ishin ne te vertete ne arenen e Maqedonise dhe qe ende luftojne me Hatushilet e trete (Hattushilis III) kunder Ramseve te II -te (Ramses II) ne Kadesh, pra ne Sirine e sotshme. Keto gjera jane te njohura prej nje numri te madh hieroglifesh ne gjuhet Asiriane, Babilonase Hite, dhe Egjyptiane.

Demosteni ishte nje Athinas famoz i cili spjegon se perse Magedo net e lashte nuk ishin Greke. Qe me 1974, asnje fragment i vetem nga Demosteni nuk eshte mesuar ne kurset e letersise antike Greke, ne ndonje Fakultet te letersise apo ndonje dege tjeter te universiteteve Greke. Problemet e Greqise me Turqine nga ana tjeter jane te perhereshme. Shprehja e pare e diplomacise Greke dhe ideve politike Greke ne nivel nderkombetar eshte i ashtu quajtura anti - Turqizem.

Ky eshte nje realitet i ri derisa ne fillimin e shekullit te ka luar shteti Grek nuk ishte as nje domosdoshmeri e as nje realitet. Ai ish te thjesht rezultat i gatishmerise se Frances, Britanise se Madhe dhe Ruses per te destabilizuar Perandorine Osmane, te benin shtete me dallim etnike jashte territoreve te saj ne Ballkan. Kjo gatishmeri nuk korespondon me ndonje zell te domosdoshem per pjesen tjeter te ketyre territoreve.

Ndertimi i shteteve nuk korespondon me interesat e popujve ne fja le sepse shume popuj jetonin nen Perandorine Osmane ne nje shtate te mire por e bene keshtu per interesat dhe konfliktet e ndryshme, nga njera ane te Frances dhe Britanise dhe ne anen tjeter Rusise, pasi kete te fundit Franca dhe Britania doninta pengonin per te mos dale ne detrat e ngrota.

Greket jane mesuar ta pandehin veten sikur jane qendra e botes. Pa asnje diskutim ky mentalitet krijon probleme per te gjitha fqinjat e saj. Dikur u shfaq nje lloj kombinacioni interesash midis administrates se Orto dokseve, nacionalisteve dhe ish komunisteve Serbe, dhe pastaj midis administrates Serbe te fundit te viteve 1980 dhe fillimit te 1990 - tes e kthyer ne nje aleance normale per Greqine.

Pas kesaj nje destabilizim edhe me i keq u shfaq ne Ballkan. Greqia bashke me Serbine jo vetem qe kane formuar nje aks kunder te gjitha vendeve te tjera dhe popujve te rajonit, por duke u bere nje aleat i Serbise Greqia i siguroi forcen dhe idealet anti Evropiane e nacionaliste gje qe duken sheshit ne zhvillimet e sotshme politike ne Greqi.

Eshte bere e zakonshme per shume politikane dhe intelektuale qe te flasin kunder Evropes. Nje rast i tille eshte ai i librit te shkruar prej shkenctarit te shkelqyer te shkencave politike, profesorit Francez Zhan Baptist Doruselle dhe sponsorizuar nga ana e Komunitetit Evropian i cili eshte kritikuar ashper ne Greqi si anti Grek per shkak se ai nuk perserit idete fallse te Grekerve mbi historine e Greqise dhe te qenit e Greqise si qender e botes dhe djep i kultures se nje rezimit. Rreth ketij libri vazhdon te kete komente brilante dhe shenime te

shkelqyera neper tere Evropën çka vertetohet me perkthimin qe i eshte bere gati ne te gjitha gjuhët Evropiane. Per shkak te "r e s p e k t i t" Grek per lirine ky liber nuk mundet dhe nuk duhet te perkthehet dhe te botohet ne Greqi. "I n t e l e k t u a l e t" dhe politikanet e ndalojne botimin e ketij libri ne nje vend qe ende konsiderohet Evropian.

Eshte Kisha Ortodokse Serbe ben politiken e jashtme ne ate vend, gje qe ngjall lakmite e Grekerve per te bere te njejten gje ne vendin e tyre. Te njejtat gjera vihen re ne lidhje me Shqiperine ku politika e jashtme Greke nuk interesohet per shkolla per Greqisht - folesit por kerkojne "kisha per Greket" Mjafton kjo per te treguar se Greqia eshte nje vend jo - Evropian dhe ajo ka fare pak te beje me shtete sekulare e laike si Gjermania Franca apo Hollanda.

Nga ana tjeter problemi me Republikën e Maqedonise eshte me i keqi. Ne kete rast, identiteti i nje popullsie te tere eshte mohuar. Me shume se 200 libra kane qarkulluar ne Greqi tre vitet e fundit lidhur me Maqedonine. Megjithate asnje nga autoret e ketyre librave nuk eshte specializuar ne Maqedoni. Sigurisht qe asnjeri prej tyre nuk ka idene e historise se lashte. Ato çfare ata perseritin eshte adaptuar prej vete Grekerve, dhe tani ne kete mynyre, eshte formuar nje popull racist ne Jug te Ballkanit.

Eshte kollaj te behet nje popull qe te pranoje idete raciste. Rasti i Gjermanise Naziste e verteton kete me se miri. Ne se kundërshtimi i dogmes historike nuk lejohet atehere populli vjen tek ato mendime dhe ndjenja tek te cilat erdhen Gjermanet me 1934, 1938 apo 1940.

Ky nuk eshte nje problem vetem per fqinjet e Greqise ne Ballkan por gjithashtu nje problem serioz Evropian pasi Greqia eshte ende shtet antar i Bashkimit Evropian.

### 3. QENDRIMI GREK NDAJ TURQISE

Greket marrin nje informacion fallse e te shtrembe ruar rreth Turqise dhe askush ne Greqi nuk lejohet te kerkoje qe te ndryshoje diçka ne kete drejtim. Turqit thirren "B a r b a r" ne Greqi. Por si mund te konsiderohet nje popull qe ka ndertuar Xhamine Blu nje popull barbar? Askush ne Greqine e sotshme nuk eshte ne gjendje te ndertoje diçka te ngjashme me madheshtine e Xhamise Blu dhe ky eshte vetem nje nder shembujt qe mund te jepen.

Pos te gjithave, lehtesisht mund te arrihet ne perfundimin se Perandoria Osmane ne fillimin e shek. 19 - te e pranoi shtetin Grek, pasi qe Greqia ishte pjesa me e parendesishme per te, e njekohesisht pjesa me e pakulturuar, me pak intelektuale, me pak e qyteteruar dhe me pak e rendesishme.

Ne kete kontekst, duke folur per te ardhmen, une besoj se nje bashkepunim midis Turqise dhe Evropes ne kete drejtim duhet te filloje. Kjo ben te domosdoshem nje status per vendet Evropiane per te bere qe brenda Evropes, vende si Greqia nuk kane vend.

Ne qofte se Evropianet e detyrojne Greqine qe te pranoje ate qe mund ta quajme normalitetin i nje zeri tjetere ne Greqi, ne se Greket do te pranojne te botojne tjere libra, te pranojne tjera ide, tjera analiza politike, atehere nje debat shume i gjere mund te ndermerret ne Greqi. Rezultati do te qoje tek ajo qe shume Greke do te fillojne te ndryshojne idete e tyre dhe mendimin per Turqit i cili eshte nje popull shume i qyteteruar qe i ka kontribuar aq shume historise se botes si dhe vete historise Greke, e gjitha kjo duke shkuar drejt nje zhvillimi pozitiv per afrimin e popujve.

Ne te vertete Greket te cilet jetojne midis Turqve kane patur nje mendim te mire per keta te fundit. Ishin vetem Grekerit e atij vendi te vogel te pavarur ne Jug te Ballkanit te viteve 1830 - 1840 qe filluan te kishin nje ide te shtrember rreth Turqve, per shkak te perhapjes se dogmes se genjeshtert Greke te permendur tashme sa here.

Per 8 vjet, vazhdoi e ashtuquajtura lufte per pavaresine e Greqise. Ne keto vite ushtria Osmane ishte atje dhe te gjitha shkatrrimet per funduan ne nje veshtiresi per te patur nje kuptim te paanshem per te. Pos te tjerash Greket te cilet jetonin ne nje vend te pavarur pranuan shtetin e tyre te ndertuar mbi bazat e nje ideologjie historike te genjeshtert duke u kthyer me vone ne viktime te ketij shteti.

Megjithate, çeshtja eshte se mund te luftohet kunder kesaj te keqje duke perhapur te verteten kundrejt dogmave. Une besoj se i gjithë spektri i kesaj dogme te genjeshtert historike dhe i konstruktit ideologjik te qyteterimit "Greko - Ortodoks" mund te jete nje fushe shume pjellore per mbrojtje titujsh shkencor ne universitetet Evropiane dhe Amerikane. Me se 100 tema mund te kete per keto subjekte.

#### 4. POLITIKA GREKE PER IZOLIMIN E TURQISE NGA EVROPA

Greket besojne se emri i Evropes eshte nje emer me origjine Greke, çka sigurisht, nuk eshte e vertete, duke e lidhur fjalen "Evrope" me ate Evropi ne mitologjine Greke. Megjithate ne kemi nje numer te madh deshmishe ne literaturen, arkeologjine dhe shkencat historike te shekullit te kaluar. Kemi studjuar shkrimet Ugaratike - Kananite te dy mijevjeçareve p.e.re. dhe ato Fenikase gjithashtu, te cilat na çoj ne ne konkluzionin se fjala "Evrope" eshte me origjine Fenikase.

Fjala "Erebu" ne gjuhen Asiriane do te thote, nje qe merr drejti min per ne Perendim, dhe "Erebi" ne Fenikase do te thote po ashtu, perso ni i cili niset per ne Perendim gje qe eshte krejtesisht e njejte me ate qe besonin Greket e lashte. Europa ishte nje femer e cila levizte drejt Perendimit.

Nje tjeter supozim i gabuar eshte ai qe Greket i paskan kontribuar shume formimit te Romes ne pikepamje kulturore dhe historike. Kjo ka te beje shume me nje perceptim te mbrapshte te fjales "n d i k i m" midis Grekerve.

Greket besojne, dhe kjo vjen per shkak te arsimit te tyre te ulet e te dobet, se filozofi i nje populli i shekullit te katert p.e.re. ndikon tek nje filozof i nje populli tjeter i shekullit te trete p.e.re. Kjo s'ka te beje fare me te verteten e evolucionit historik.

Evolucioni historik ka te beje me shume me influencat e ndersjellta ne bestytnite e popullit, kultin, fene, filozofine popullore, ideologji ne artin etj. Le te marrim si shembull popullsine Kelte, Britanike, Tektonike ne qender te Evropes, Skythet ne Rusine e sotshme Jugore, dhe po keshtu popullaten Iberike e bile Romake te cilet adhuronin Isis ose Mithras ose ishin influencuar prej esoterizmit te Mithraikut ose Isiakut. Megjiha ate as nje tempull Grek nuk gjendet jashte zonave Greqisht - folese dhe Athinaja, perendesha e Athinasve antike, nuk duket te jete shperndare ne Francen, Gjermanine apo Britanine e sotshme.

Roma, si Rome perandorake, u formua kryesisht prej kulteve dhe ideologjive orientale, kultet e Gnostiçizmit, Hametizmit, Mithraizmit, Isiacizmit, te Ostanizmit dhe Kaldanizmit dhe jo prej filozofeve Greke; vetem pak filozofe Romake te shek. te pare p.e.re. u ndikuan prej disa ideve te filozofeve te lashte Greke. Por keta filozofe shume te lashte Greke, Plato p.sh. ose te ashtuquajturit filozofet e para -Sokratit, perseritnin te gj

the ide te njohura te filozofise dhe ideologjise se Orientit te lashte.

Gati per te gjithë Pitagora, Thales, Anaksimandros, Anaksimenos e vete Platoni shkuan ose ne Egjypt ose ne Babiloni ose ne te dyja dhe studjuan atje. Eshte Dihet se shume mite te ashtuquajtura mite Platonike ja ne pikerisht versione Greke te miteve te lashta Egjyptiane.

Miti i Atlantit, per shembull s`ka asnje baze krijimtarie filozofike Greke. Ajo ka te beje me shume me te ashtuquajturen "Rrefenja e anijes se mbytur" Ky eshte nje tekst i lashte Egjyptian i shek 19 p.e.re. qe eshte edhe fundi i Mbretërisë se Mesme Egjyptiane dhe lidhet me nje shoqëri perfekte te parajsës duke qene me nje ishull rreth te cilit gjendet nje oqean, nderkohe qe ky ishull dhe kjo shoqëri ideale kane nje fund te papritur dhe jashtezakonisht te pafat.

Nga ana tjeter idete kozmologjike te Grekerve te lashte, idete e tyre rreth krijimit te botes, ishin gati te gjitha versione te miteve dhe ideve te Sumerianeve, Asirianeve, Babilonasve, Hiteve dhe Egjyptianeve Por mbi te gjitha Roma nuk eshte formuar prej Greqise.

Krishterimi, nga ana tjeter s`ka asgje te beje me Greqine, sepse Greket nuk e pranuan Kristianizmin keshtu qe Mbret Theodos (Theodosius) iu desh qe te vriste gati njeqint mije Greqisht folës ne Selanik per te bere te mundur vendosjen e Krishterimit ne keto ane.

Ky veshtrim i shkurter historik provon se Greket kane nje perceptim te shtremer per formimin e Perandorisë Romake, te kultures Romake dhe bazave te qyteterimit Evropian i cili eshte klasik dhe Romak me shume se çdo gje tjeter. Ajo qe eshte me e keqja eshte se Greket mendojne se Evropa Perendimore ne Mesjete ishte nje "r a j o n b a r b a r" duke bere te njejtin arsyetim edhe per Orientin Islamik.

Qendra e botes ishin Abasidet ne Bagdat dhe jo "Konstandinquli Bizantin", qyteterimi i te cileve kaloi nga arabet ne Evropën Perendimore kryesisht ne rrugen nga Kalifati Islamik tek Kordova (Cordoba). Greket e sotem te Anatolias e pranuan Islamin ngadale dhe kjo si rrjedhoje e punës se jashtezakonshme te Mevlana Xhelaledin Rumise i cili studjoi neo - Platonizmin, Plotnin dhe Platonin duke i dhene nje version autentik Islamit i cili mund te kete qene kuptuar me mire prej Grekerve. Kjo eshte krejtësisht e panjohur ndersa fjalen "Roubaiyat" nuk e din kerkush ne Greqi. Ne se guxonit t`ja thoni kete fjale ndonje Greku "te mesuar" ai do te mendoi se ju po i flisni ne Hungarisht ose diçka te ngjashme me kete.

Formimi i Evropes moderne ka te beje me shume me materiale te sjelluara nga vendet Islamike dhe arabike si: Maroku, Egjypti, Bagdati, Ira ku, nga Perandoria Osmane dhe me pak Gregia Antike.

Perceptimi i shtrember i fjales "influence" ka gjithashtu nje tje ter rreth problemesh ne supozimet e Grekerve te sotshem rreth formimit te Evropes. Ajo qe eshte quajtur Rilindje nenkupton nje refuzim te plote te Mesjetes dhe nje lloj kujtimi i idealeve te lashta Greke dhe Romake.

Eshte i vertete fakti se ka edhe shume kujtime nga Egjypti i lash te, me te cilat intelektualet e Rilindjes ishin shume mire te paisur. Ceshtja eshte se neqoftese dikush don te refuzoje diçka, pra ate qe mund te quhet statusi religjioz i Mesjetes duke u mbeshtetur keshtu ne qytete rimet e lashta, kjo s`do te thote se qyteterimet e vjetra influencojne ne te.

Nbshita ne qofte se Hitet ishin te njohur, nese gjuha Asiro - Babilonase ishte e njohur dhe po keshtu ne se hieroglifet Egjyptiane do te ishin te njohura ne kohen e intelektualeve te Rilindjes, ata do te kishin gjetur mjete me te mira per te luftuar kohen e erret te Mesjetes ne Egjyptin e lashte, Mesopotami, dhe Anatoli, por ne ate kohe asnje s`mund te fliste per influencia Hite tek intelektualet e Rilindjes. Ajo qe ne e quajme Rilindje s`ka fare te beje me Gregine Klasike dhe Gregia Klasike s`ka te beje fare me Greket e antikitetit te vone.

Tek e fundit ne se Gregia nuk influenconte tek Greqisht - folesit dhe Greket e dyqint vjeteve me vone, pas periudhes klasike te Greqise, si mundi Gregia klasike te influencoi tek Rilindja ose tek popuj qe jetonin nje ose dy mijevjeçare te mepastajme.

Asnje person i vetem, bile as edhe nje profesor i vetem ne Greqi, nuk e di dhe as qe perhap idene dhe faktin historik se te gjithë Ptolemejt ne Egjypt i refuzuan idete politike te Perikliut te Athines, qe Perikliu, Soloni apo Kleisteni (Cleisthenes) s`kuptonin asgje nga Ptolemejete, bile as nga vete Aleksandri. Ceshtja eshte se Aleksandri u habit me ato qe pa ne Iran dhe ne Egjypt. Aleksandri, atehere u be faraon duke e pranuar veteveten si djale te Amon Rase duke gjetur keshtu ne Babiloni vendin me te mire per kryeqytetin e Perandorise se tij.

Ptolemejte per dy shekuj shkruan me hieroglifet Egjyptiane, ne kollozat e tempujve dhe jo ne gjuhen Greke. Ptolemejte ishin faraone dhe jo m breter te shteteve Greke ose politikane dhe shtetare; e gjitha kjo ne se perhapet ne Greqi e demton iden e centrizmit - Grek dhe sipas administrates ata qe guxojne ta bejne kete konsiderohen anti Greke dhe armiq te Greqise.

Thelbi i asaj që ekthen çeshtjen prapë tek Evropa është se Greqia sot nuk ka mundësi të krahasohet me evolucionin kulturor dhe intelektual Evropian duke u kthyer në një rrezik për Evropën, gjë mund të kuptohet fare lehtë prej Evropianëve.

Idealet të cilat e formojnë mentalitetin e sotshëm Grek janë ato që Evropa i provoi në luftën e dytë Botërore, prandaj edhe Evropa nuk dëshiron t'i provojë për herë të dytë; Kështu që unë besoj se pasi të përhapet ky material në Evropë, mund të bëjë që Evropianët perëndimorë të menjtëherë se si të reagojnë ndaj një rasti të tillë.

Veç kësaj Greket mendojnë se Greqia ishte baza e Evropës dhe e konsiderojnë Greqinë si një kundërshtarë të Turqisë. Ata gjithashtu e mendojnë në Turqinë kundërshtarë të Evropës ose Evropën kundërshtarë të Turqisë, gjë që s'është aspak e vertetë.

Është i mirnjohur fakti që Sulejmani i Madhërisëm (Kanuni) kishte një aleancë të fortë me mbretërit e Francës dhe që Volteri, Lamentini dhe Rusoi e admironin Perandorin Osmane, ku gjeten shumë elemente pozitive kur e themeluan ideologjinë e tyre politike gjë që është fort mirë e njohur edhe në Evropë.

Prandaj Greket duan të parandalojnë ndonjë urë intelektuale, kulturore, historike, politike apo ideologjike midis Evropës dhe Islamit për shkak se ata e duan Evropën të bëhet një Evropë Greko - centriste. Pa dyshim që Evropa nuk do të ketë pengesa në zhvillimin e vet dhe në kuptimin për Islamin e kështu mijërat e studjuesve Evropianë nuk do të humbin një urë të tillë lidhëse.

Në ndërtimin e kësaj ure, Turqia ka një rol të madh për të luftuar dhe të gjithë duhet të besojnë se Turqia mund të jetë pjesa qendrore e kësaj ure. Unë gjithashtu besoj, përderisa jam musliman, se Islami mund të zgjidhë shumë prej problemeve të sotshme, përderisa evolucionin intelektual dhe kulturor Evropian në shekullin e kaluar nuk korrespondonte gjithmonë me atë çfarë studjuesit dhe intelektualët në Evropë dëshironin në shek. 18 -te e 19 -te-

Bota teknologjike, qytetet e mbipoplluara, ndotja e hapsirës, vendi i njeriut në natyrë, dhe shumë probleme të konceptimit moral të botës dhe të jetës mund të zgjidhen nepermjet të një ure të tillë midis Islamit dhe Evropës. Greqia s'ka asgjë për të afruar në lidhje me këto çështje, qoftë Greqia me të kaluarin e saj historikë, qoftë pseudo Greqia e sotshme shteti anakronist dhe nacionalist i Ballkanit.

Une preferoj termin "p s e u d o - G r e q i", per ate shtet i ci li eshte i perbere prej Grekesh, Greke te vertete, te cilet shkuan nga Tur qia, nga Anatolia apo nga Stambolli, prej Shqipetaresh qe thirren Arva nitas por qe megjithate jane Shqipetare, prej Maqedonesh, prej Arabesh te Kretes, prej Vllahesh, nje popull latin foles, prej Katolikesh, prej Roma kesh si dhe prej nje popullsie te tere Sllave e Greqizuar dalengadale pas shek te 15 - te.

## 5. CESHTJA E QIPROS DHE GREQIA

Para se gjithash, Qipro nuk eshte Greke por Qipriote. Qipro, "K i p r o s" ne Greqisht, eshte nje fjale krejt Fenikase qe do te thote "B r e g d e t". Qipro eshte ne te vertete balle per balle me Fenikasit. Deshmia e pare ishte ne Qipro dhe jo ne Tunizine e sotshme. Kart haddasht eshte nje emer Fenikas, qe do te thote "qytet i ri". Disa tregetare ndertuan nje qy tet te ri. Atehere deshmohet edhe i pari shkrim ne Fenikase. Ky Karthag (Kart haddasht, qytet i ri) nuk ishte ai i Tunizise se sotshme por nje ko loni Fenikase ne Qipro. Komponenti Semitik i historise se Qipros ishte gjithmone i nje rendesie te veçante edhe perpara edhe pas ardhjes se Isla mit.

Qipro moderne nga ana tjeter ka dy popullata, Greke foles dhe Tur qisht foles, ortodokse dhe muslimane. Pas formimit te shtetit te Qipros, ve çanerisht me 1964 u ndermoren shume masakra kunder popullsisë Turke.

Idea fallse e ENOSIS - it qe do te thote bashkim i Qipros me Gre qine, u perhap dhe u propogandua sa tek popullsia Greke e Qipros aq edhe tek popullsia Greke ne Greqi. Duhet te mos harrohet fakti qe personi i ci li ishte zedhenesi me i mire i ketij unioni ne vitet e fundit 50, dhe te fillimit te atyre `60, gjenerali Grivas, ishte gati te behej udheheqesi i nje Partie politike te qendres ne Greqi.

Ai nuk u be por kjo mjafton per te kuptuar se ne sistemin e soten politik te gjitha partite politike, e djathta, e majta apo ato te qendres jane variante te Le Penit te sotshem Francez.

Diçka kritike ndodhi ne Qipro me 20 korrik 1974, por ajo çka ish te me kritike ishte ajo e 15 - tes, dhe ajo qe ndodhi me 15 korrik 1974 u denua nga vete Presidenti Makarios ne fjalimin e tij ne Kombet e Bashkuara me 18 Korrik 1974. Ky fjalim mund te gjindet vetem ne nje liber modern Grek. Kjo tregon me se miri interpretimin e vertete te fakteve te paraqitu ra nga Makarios ne OKB, te papranuara prej politikaneve Greke.

Nuk është ende e qarte nëse ata e kanë tejkaluar idenë e tyre të të qenit të Qipros në një vend Grek. Kjo është arsyeja kryesore për vazhdimin e problemit. Une besoj se e verteta midis dy paleve në ishull do të gjendet. Pas gjithë këtyre debateve, diskutimeve, kontakteve, interpretimeve, ideve të shprehura gjatë 20 vjetëve, asnjë lloj besimi midis paleve nuk u arrit. Kjo është diçka shumë e keqe. Prandaj mund të shqyrtohet ndonjë ide e re për mundësinë e njohjes nga ana e Greqisë e Republikës Turke të Qipros së Veriut.

Republika Turke e Qipros së Veriut është një shtet me zgjedhje të lira, me Parlament, me institucione të plota në një zonë të caktuar dhe shumë të rëndësishme. Në Evropë, Lihtenshtejni është një shtet me të gjitha cilësitë dhe jo një "pseudo shtet", e pra është më i vogël se sa Qipro e Veriut.

Une arrij në përfundimin se një njohje e Republikës Turke të Qipros së Veriut nga ana e Greqisë, paralel me njohjen nga ana e Turqve të Qipros së Jugut, mund të jetë instrumenti më i cilin të dy palët të ndërtojnë marrëdhënjet e dyanëshme. Kjo do të bënte që pas disa vitesh të mund të flitet për një lloj federate. Kjo nuk është e pamundur po të shohim se sa pak ka evoluar çështja Qipriote në këto 20 vjetë ndërkohë që problemi nuk mund të përjetësohet.

#### **ShBA, Bashkimi Evropian dhe çështja Qipriote.**

ShBA - të mund të dëshirojnë të kenë baza të reja në ishull gjë që s'është aspak e mirë për të. Bazat Britanike janë gjithmonë aty dhe krejt të mjaftueshme. Ndoshta Evropa mund të ndihmojë me shumë, dhe të dy shtetet e Qipros të bëhen antare të Bashkimit Evropian. Për këtë Bashkimi Evropian duhet të njohë Republikën Turke të Qipros së Veriut.

#### **Turqit në Thrakine Perendimore**

Fakti që në Thrakine Perendimore ka Turq nuk mund të mohohet. Kur Turqit e Thrakise deklarohen se janë Turq, dërgohen në burg. Ky është një anomalitet në një vend Evropian. Qdo Spanjoll, Italian, apo Tunizian qof të që jeton në Francë e deklaroi pa frikë origjinin. Kjo nuk përben asnjë problem për Francën. Ateherë pse duhet të përbejë problem për Greqinë?

Siç mund të merret me mend është e drejtë e ligjeshme e çdo populli pra edhe e Turqve të Thrakise Perendimore të riparohen ndërtesat dhe xhamitë e tyre. Për këto të drejta nuk janë akorduar ende nga regjimi Grek që përben vetëm njërin aspekt të problemit. Aspekti tjetër është se Greket zbatojnë një ligj kom

plet anti demokratik, pra nenin 19 te Kodit Civil i hartuar posaçerisht per Turqit e Trakise Perendimore.

Sipas ketij neni, ne qoftese nje Turk i Trakise Perendimore shkon ne nje vend tjetër, autoritetet ia konsiderojne atij levizjen si "largim te perhershem"; kjo vjen pasi Turqit e Trakise nuk konsiderohen si qyteta re te Greqise plotesisht e keshtu qe kur ai kthehet perseri per ne vendin e tij i thuhet me ironi: Ne menduam se ju do te gjenit nje tjetër situatë dhe pune ne nje vend tjetër, prandaj ju tani nuk jeni qytetare Greke dhe tani e tutje nuk mund te hyni ne Greqi."

Ky eshte nje realitet i nje situatë anormale qe i pret shpresat per mardhenje me te mira me Turqine. Kjo nuk eshte nje çeshtje vetem per Turqine, por ajo eshte po aq per Evropën e cila duhet te nderhyje tek Greqia per te anuluar menjehere kete ligj antidemokratik.

Çdokush mund te shpreh zemerimin e vet per faktin qe ne Athine nuk ka xhamia. Athina, i vetmi kryeqytet i Evropës pa nje xhami; Kur Karamanlisi, ne ate kohe kryeminister, vizitoi Riadin me 1978, Sauditet i ker kuan atij mundesine e ndertimit te nje xhamie ne Athine dhe Karamanlisi e pranoi oferten. Ambasada e Arabise Saudite ne Athine solli atehe re tere ato materiale per ndertimin e Xhamise. Por, kuptohet, pas nderhyrjes se te plotefuqishmes, Kishes Greke (pasi ajo eshte pjese e aparatit shteteror) gjithëçka u nderpre, dhe, edhe sot e kesaj dite xhamia nuk eshte ndertuar. Ky eshte nje turp per nje vend ne te cilin jetojne kaq shume musliman duke perfshire ketu jo vetem muslimanet Turq, por gjithashtu ata Arabë, Pakistaneze te cilet jetojne ne Athine. Atyre nuk u jane dhene mundesi te qe te praktikojne besimin e tyre.

### **Shoqeria Turke dhe Greqia**

Shoqeria Turke ne pergjithesi dhe ajo e komunitetit intelektual Turk ne veçanti mbajne nje qendrim shume miqësor ndaj Greqise dhe Grekerve, Intelektualet Turq nuk i kuptojne dot ndjenjat armiqësore te nje pjese te administrates Greke. Intelektualet dhe akademiket ne Turqi jane shume me Evropiane se sa ata Greke dhe te nje niveli shume me te larte.

Lendet humanitare mesohen ne universitetet Turke ne nje forme shume progresive dhe Evropiane, pa asnje lloj shtremberimi apo fallsifikimi te historise.

Une jam fare mire i njohur me akademiket Turqë dhe leksionet e tyre te cilat nuk jane aq te njohura per boten. Bota sot nuk arrin te vleresoje ate qe Turqia e sotshme eshte shume me e rendesishme se ajo e viteve 1960 - te.

E theksoj kete pasi qe Turqia u be nje shtet laik qe ne kohen e Ataturkut. Une mendoj se shume Turq besojne se ka nje lloj kontradikte midis Kemalizmit dhe Islamit. Une nuk mendoj keshtu; Une besoj se ajo qfare Kemal Atatürk beri ne kohen e vet ishte nje hap shume pozitiv, sepse ne ate moment ky ishte nje hap normal per te gjitha vendet dhe ai keshtu beri.

Une besoj sinqerisht se me te kaluaren e saj, Turqia mund te behet nje ure lidhese midis shoqerive "laike" dhe sekulare te Evropes dhe Islamit. Turqia mund ta kuptoje Islamin me mire se sa Evropianet dhe nga ana tjeter mund ta kuptoje Evroperen me mire se sa vendet tjera muslimane. Prandaj, Turqia eshte vendi qendror per lindjen e nje ideologjie te re. Me gjithate une nuk jam krejt i sigurte ne se Turqit, veçanerisht intelektualet Turq i japin rendesine e mjaftueshme kesaj çeshtje.

P J E S A E D Y T E

EVOLUCIONI POLITIK NE BALLKAN, MARDHENJET GREKO  
BALLKANIKE DHE TURQIA:

Nje vend i pakenaqur me ndryshimet paqesore ne Ballkan Zhvillimet politike ne Ballkan ne fundin e viteve `80 perhapen shpresen e nje zgjerimi te Bashkimi Evropian dhe te vendosjes se lirive te verteta ne Evropen Lindore, thene me sakte ne Ballkan, arena e djegur nga kaq e kaq luftera. Megjithate kjo shprese nuk eshte materializuar deri tani.

Dy faktore kryesore te destabilizimit te paqes na Ballkan jane ve ne re tashme nga studiuesit e politikës, historianet, intelektualet, diplomatet, politikanet dhe shtetaret ne Evrope dhe ne Amerike: dy vende qe nuk pranojne mirekuptimin dhe idealet mbi te cilat jane vendosur shogerite moderne demokratike ne Evrope, Ameriken Veriore vete Bashkimin Evropian: Keto jane Greqia dhe Serbia.

Eshte nje vend qe nuk pranon qenjen e minoritetit te vet jashte kufijve dhe qe perpiqet te zптоje pjese te vendeve fqinje. Dy viktima deri tani jane Kroacia dhe Bosnja. Kur diskutohet rreth minoriteteve etnike qe jetojne ne kondita miserabel ne kete vend, atehere rregjimi i ketij vendi i deklaron ato zona ku jetojne minoritetet si "toka historike te rendesise se gemotshme". Ky vend eshte Serbia.

Eshte edhe nje vend tjeter qe perpiqet te tregojë se eshte vendi me i zhvilluar ne Ballkan. Ky vend eshte ende - dhe kjo eshte e pabesueshme - shtet anetar i Bashkimit Evropian, ushtrues i drejtuesit te presidentes ne gjysmen e pare te `94 - es. Ky vend nuk pranon qenjen nacionale te ndonje vendi tjeter dhe perhap nje version te shtremberuar, racist e falls te historise - sipas te cilit emri i çdo vendi tjeter mbi te gjitha eshte "G r e k"

Ky vend perpiqet te zптоje dy vendet fqinje per aresye se atje ja ne "minoritetet etnike". Edhe perkunder faktit qe ende nuk eshte provuar qenja e minoriteteve te tilla, ky vend nuk don te therrase ne emer nje tjeter minoritet etnik i cili jeton ne pjesen e vet veri-perendimore. E keshtu eshte edhe nje minoritet magedon ne Greqi

Ne fakt pikerisht ky vend trillon nje minoritet unik ne bote: "mino-

ritetin musliman". Megjithate dihet mire se nuk ka gjuhe muslimane, dhe qe emri etnik (dhe emri kombetar) eshte kryesisht i varur prej gjuhes se nezes si nje populli apo minoriteti. Ky vend eshte Greqia. Metodrat falsifi kuese kane bere te domosdoshem ngritjen e nje departamenti te Studimeve Politike dhe Humanitare ne Universitete.

Qellimi eshte te analizoj menyren se si ky vend be het nje faktor destabilizues ne Ballkan; te studjoj se mbi q`baza te mardhenjeve me shtetet e tjera te Ballkanit i ka ndertuar mardhenjet, varesisht nga histeria unikale anti turke qe e ben Greqine aktualisht shembull te veçante ne bote.

### 1.- MARDHENJET GREKO - BULLGARE

Ka ekzistuar tradicionalisht nje anti - bulgarizem nga ana greke. Origjina mund te kerkohet qe ne shekullin e gjashtembedhete. Perandoria Romake Lindore e fitoi mbiemrin "Bulgaroctonos" (Vrases te Bullgareve) ne fund te shekullit te dhjete. Mardhenjet armiqesore i karakterizuan dy entitetet bile edhe pas perhapjes se Kristianizmit Ortodoks midis bullgareve. Pas sllavizimit gjuhesor dhe kulturor te bullgareve preferenca Romano - Lindore (dhe Orthodokse) per serbet mund te deshmohe aty nga shekulli i trembedhete.

Formimi i "Bullgarise se madhe" per nje periudhe te shkurter me 1878 u percoll me alarm e shqetesim ne shtetin e vogel grek te ateher shem ne Jug te Ballkanit. Nje gje e tille do te lente disa grek-foles ne territorin Bullgar dhe do ti jepte nje goditje te rende "MegallOideas", idea politike greke e zevendesimit te Kalifatit Osman me nje Perandori te re te Bizantit Grek Ortodoks.

Per me keq, perspektiva e "Bullgarise se madhe" do te thoshte per themeluesit Greke qe Bulgaria ishte nje aleat me i mire i Rusise per te plotesuar deshiren e Carit per influence ne Jug dhe per te pasur nje rruge ne detrat jugore. Per gati nje gjysem shekulli (1878 -1912), balancimi i mire i politikës se jashtme bullgare midis Rusise dhe Gjermanise lente te kuptohej se Greqia nuk mund te mbeshtetej ne keto fuqi per realizimin e projekteve te saj anti Otomane.

Kjo kishte nje efekt shkatrrimtar per palen Ruse ne Athine e cila kishte shume influence (veçanerisht perpara 1860 - tes) dhe kufizonte gjithashtu perspektivat e pales

Gjermane ne Athine, perkunder faktit qe pala Ruse ishte mbe shtetur prej Kishes Ortodoksedhe, pala Gjermane ishte drejtuar prej vete mbretit qe ishte nje Gjerman. Vetem ne fillimin e viteve '80 partite politike Angleze e Franceze filluan te influencojne vertete ne Greqi.

Çeshtja Maqedone dhe dy luftrat Ballkanike percaktuan politiken dhe deshirat pro serbe e anti Bullgare. Pas nje lufte civile dhe ndarjen e shtetit verior Grek te Selanikut (1915) i cili ndodhi per shkak te interesave te Fuqive te Medha, Venezillos dhe partite Angleze e Franceze deshiro nin bashkengjitjen e Greqise Antantes, nderkohe qe mbreti mundohej ta mbante Greqine neutrale - çka ishte nje favor i madh per interesat Gjermane ne rajon - dhe pas zgjidhjes se "**Ceshtjes Lindore**" nepermjet te Traktatit te Lozanes Greqia vazhdoi te kete probleme me nderhyrjen Maqedone ne pjesen Greke te Maqedonise gjate vitit 1920 e 1930 kur nje diskriminim i pashembullt kulturor kishte perfshire minoritetin maqedon ne Greqi. Kjo u be nje ceshtje e madhe midis Greqise dhe Bullgarise gjate Luftes Civile Greke (1944 - 1949) atehere kur komunistet Bullgare ndihmuan te dy palet, edhe minoritetin maqedon ne Greqi edhe Ushtrine Popullore Clirimtare Greke.

Deri me 1975 mardhenjet midis dy vendeve vazhduan te jene te keqia. Pas mesit te vitit 1970, nje perpjekje e konsiderueshme greke u be per te permiresuar mardhenjet Greko - Bullgare. **Kjo ishte e ashtuquajtura marreveshja Karamanlis - Zhivkov.**

Ne fillim ishte perceptuar si "Ostpolitik" Grek ne korrespondence me marreveshjen e Helmut Shmidit me sovjetet. Ajo ishte shkalla e pare ne perspektivat e nje "Sharl De Goli Grek". Megjithate ajo u kthye ne nje tjetër aspekt te anti turqizmit Grek ne drejtim te fillimit te nje diskutimi ne se mund te jete Turqia nje vend Ballkanik apo jo.

Duhet pranuar definitivisht ndryshimi i politikës Greke pas Krizes se Qipros me 1974. **Tani, ne duhet ta pranojme kete marreveshje si hapin tjetër te terheqjes se Greqise nga krahu ushtarak i NATO** .s Pozicioni anti amerikan ne pergjigje te politikës se Henry Kizingerit per rastin e Qipros, ishin shfrytezuar prej aleatit me te mire te BRSS, Bullgarise.

Karakteri anti - Turk i marreveshjes Greko - Bullgare mund te kuptohet me mire po te kemi parasyshe mbeshtetjen qe Greqia i dha Bullgarise ne kohen e traumave te vitit 1980, veçanerisht ne rastin e politikës se brendshme diskriminuese, antiturke te Bullgarise. Bulgarizimi ne mase i minoritetit ne Bullgari (politika totalitare e ndryshimit te emrave me pashtesat sllave "ov") mund te jete nje inspirim Grek dhe korespondon

me praktikat politike Greke dhe me perpjekjet antidemokratike per te zhdukur fjalën "Turk" ne Greqi dhe per ta zevendesuar ate me fjalën "Musliman" aq sa edhe minoriteti Turk ne Greqi eshte i shqetesuar.

Qellimi kryesor i nje politike te tille ishte ti beje Bullgaret ta konsiderojne Turqine nje armik. Ishte, prandaj nje eksport i racizmit qekurse ky perceptim i qarte ekziston ne Greqi dhe eshte sot ne themelet e nje ideologjie dhe politike raciste. (Nazizmi Gjerman ishte i "rrezikuar" prej Frances, Rusise Bolshevike, Polonise se pafuqishme, Belgjikes se vogel ose Danimarkes indeferente:)

**Afersia tradicionale Greke me kombin Bullgar ka qene: "Bullgari qe mundet me qene me i miri eshte ai i cili eshte helenizuar, perkatesisht Greqizuar."**

Hapja e te pares shkolle te mesme Bullgare me 1835 ishte pa dyshim rezultat i revolucionit Bullgar, por ky veprim u cilesua si komplot anti-grek. Kjo duket si e çuditeshme, gje qe nuk eshte e tille, derisa politika tradicionale e Patriarkanes se Stambollit gjate periudhes se sundimit Otoman ishte te perhapte gjuhen Greke midis tere besimtareve ortodoks te Kalifatit.

Gjuha Greke vete ishte konsideruar si nje potencial i rrezikshem kunder "fese djallezore dhe fuqise politike te Kalifatit" (Anastasios Gordius thote qe Kalifati dhe Vatikani ne shek. tetembedhjete ishin dy kembet e fuqise se djallit anti Krisht)

Megjithate, çeshtja e Bullgarise pas - komuniste u be nje çeshtje e veshtire per politikanet dhe shtetaret Greke. Duke qene viktime e edukimit te tyre, nivelit te ulte te kultures pseudo - historike, Greket besuan se fundi i epokes komuniste ishte nje fitore e Kishes Ortodokse, e traditave, dhe nacionalizmit, çka nuk eshte e vertete.

Perveç kesaj politika e re qe u ndoq nga Sofja ishte e kundert me ate te Zhivkovit sa i takon Turqve. Greket do te deshironin ta shikonin Bullgarine te bashkuar ne nje aleance Ortodokse, anti Turke, anti Islamike dhe anti Evropiane, atje ku ata e gjejne vetveten "nga ana kulturore" te forte çka eshte nje tjeter supozim fallse.

Ne vend te kesaj ata jane te zhgenjyer nga zhvillimet e fundit politike ne Bullgari. (Pjesmarrja e Turqve ne administrate, mardhenjet e mira Bullgare te vendosura me Maqedonine, marrja e qendrimit anti serb, bile edhe me keq per Greket mbeshtetja qe ata i dhane minoritetit Maqedon ne Greqi, perkunder asaj qe administrata Bullgare i konsideron Maqedonet Bullgar). Ne qofte se Bullgaria insiston ne mbeshtetjen e te drejtave te minoritetit Maqedon ne Greqi, mardhenjet Greko - Bullgare do te keqesohen perfundi misht.

## 2.- MARDHENJET GREKO RUMUNE

Rumunet kane nje imazh shume te mire tek greket. Ata jane latinfolesit "e mire" qekurse jane ortodoks. Perveq ke saj, jane munduar te heqin nje paralele midis Grekerve e Rumuneve, si popuj te izoluar e te gjendur midis popujve armiqçka eshte sigurisht nje supozim krejt i gabuar. Greket e kane pare Rumanine me me shume simpati, pasi Rumania eshte vendi nga ku filloi revolucioni "Grek" me 1821.

Ne Rumani, megjithate, çdokush mund te deshmoje nje gabim te administrates Otomane: dhenjen e nje pavaresie te kufizuar ndaj Moldavise dhe Vllahise nga Sulltani gje qe e beri ate qender te revolucionit anti - Otoman dhe agjenteve te huaj.

Rasti i Rega Velestinli<sup>t</sup> ishte krejt indikativ: Ai nuk donte nje shtet Grek te pavarur, por nje zevendesim te administrates (Otomane - Neo Bizantine / Islamike - Kristiane) ne territoret e Kalifatit. Rumania vete kur u be e pavarur me 1861, filloi kerkimet e veta per ideale politike ne trillet e Perandorise "Bizantine".

Rumania ishte shume e vlefshme per Greqine per shkak te qendrimit anti - sllav (Kjo eshte tani krejt anormal ne nje vend te slavizuar siç eshte Rumania). Qendrimi anti - Islamik anti - Otoman, e anti - Slavik i Rumanise doli ne pah ne dy lufterat Ballkanike.

Rumania ishte gjithashtu e domosdoshme per Greqine per shkak te anti - Kalvinizmit te thelle, pozicionit anti - protestant i kthyer ne nje praktike te perhereshme diskriminuese ndaj minoritetit te gjere Hungarez ne Rumani.

Perpara dhe pas Luftes se Pare Boterore, mardhenjet e mira Franko - Rumune ishin njesoje si ato Franko - Greke dhe kjo te kujton ate qe Rumania ishte nje shtet antar i "**Petit Entente**" ne mes te dy Luftrave Boterore.

Mardhenjet Greko - Rumune nuk u keqesuan aq shume pas bashkimit te Rumanise me Traktatin e Varshaves dhe KNER-in. Perzierja me maturi e Rumanise ne çeshtjet e minoritetit Vllah ne Greqi nuk i demtoi mardhenjet Greko - Rumune.

Pas vitit 1974, per shkak te kegesimit te mardhe njeve Greko - Turke, Greqise i nevoitej Rumania gjithnje e me shume veçanerisht per politiken anti - Turke ne Ballkan. Te gjithë politikanet dhe shtetaret Greke, qofshin nga e dja thta, qendra apo e majta treguan nje nderim absurd, lajkatar te pabesueshem ndaj Drakulles se Evropes Lindore, te ashtuqu ajturit "Danubi i mendimit", diktatorit Caushesku, po aq sa edhe ndaj gruas se tij te famshme, Elena e cila mendohet te ishte e plotfuqishme nga ana kulturore, intelektuale dhe arsimore.

Pas rënjes se diktatures komuniste ne Rumani, Greket e pandehen kete vend si nje pjestar te rendesishem te Aleances Ortodokse ne Ballkan. Çdokush duhet ta mbaje mi re parasyshe se pjestaret kyç te kesaj aleance anti - Evropiane te mbrapshte, referuar Grekerve, jane prej natyre, Greqia Serbia, Rumania dhe Armenia.

Shume sipermarres Grek i investojne parate e tyre ne Rumani, ndonjeri bleu gjithë floten tregtare te Rumanise po keshtu familja Alafuzos ka interesa serioze atje: Familja Alafuzos kontrollon radio stacionin Sky (rreth 40 % e auditorit te Athines), stacionin televiziv Sky, (i ndertuar rishtas por tashme i treti ne Greqi) te perditshmen me influence te mengjesit "Kathimerini" e te tjera nga masmedia.

Kjo eshte familja e juristit N.Costanantopoulos, udh eheges i partise se majte: Shume e kane akuzuar kete familje per rolin qe ka luajtur ne permbysjen e Kryeministrit te fundit Grek, Konstandin Micotaqis, kshilltari personal i te cilit, Gjeneral Gryllakis, derdhi shume para tek shume njerez te administrates Rumune per te siguruar mbeshtetjen Rumune ndaj histerise anti - Maqedone te Greqise. Duhet mbajtur mire parasyshe qe nje Rumani e pafuqishme ekonomikisht do te kete me pak rendesi per Greqine pas nje shperthimi te minoritetit Hungarez te shtypur.

### 3.- MARDHENJET GREKO - SHQIPTARE

Shqiperia eshte pare per nje kohe te gjate ne shekujt e fundit si "rajon Grek" Arena mitike e fiseve te lashta Greke te Heleneve, qe i ja pin emrin modern vendit, ishte jo Hellas, nje term gjeografik i perdorur per zonat Balkano - Jugore (Ne jug te Malit te Olimpitt) ne antikitet por Hellogia. Kjo zone mitike ka qene identifikuar padrejtesisht prej historia neve Greke te ketij shekulli me Shqiperine duke patur nje lidhje te ngusht te me pretendimin Grek qe folesit e greqishtes ne Jug te Shqiperise jane "Greke"

Ne perceptimin Grek per Shqiptaret eshte lehte te dallohet pamund esia e te pranuarit te tyre si shumice islame dhe qendrimin e tyre te the lle anti - katolik. Grekerit kane qene per shume kohe te preokupuar me Shqiptaret, duke i konsideruar Iliret, stergjysherit e Shqiptareve te sot shem si "Grek" cka eshte pa dyshim nje gabim.

Mardhenjet midis Grekerve dhe Shqiptareve kane qene te cuditeshme gjate dy shekujve te fundit. Idea kryesore qe e pershkon eshte ajo e te qe nurit te tyre anti - Turk nga menyra se si disa prej tyre u perzien gjate periudhes se Fuqive te Medha ne ate qe quhet "Revolucioni Grek"(1821-1828)

Musliman, katolike apo ortodoks, shqiptaret kane qene te perbuzur prej grekerve. Shqiptaret muslimane jane quajtur "Turkalvanoit" ne Greqi dhe ky eshte nje emertim perbuzes.

Dekadat e fundit te izolimit te Shqiptareve shkaktuan probleme eko nomike dhe varferi duke i dhane shans fyerjeve greke te karakterit racist ndaj shqiptareve. Thuhet se shakaja me e shkurter qe mund te shprehet me dy fja le eshte "Turist Shqiptar". Qekurse Shqiptaret jane konsideruar "Barbar" e vetnija mundesi per t'u bere te civilizuar mund te jete"te pranojne" Krist janizmin Ortodoks.

Eshte per kete arsye qe Shqiperia eshte pare si nje arene tradici onale e ekspansionit Grek gjate dy shekujve te fundit. Sa kohe qe Shqipeta ret nuk e pane te nevojshme qe te shkeputeshin prej Kalifatit Osman'i vet mi pozicion Grek ne lidhje me kete zone ishte qe ajo duhej ndare midis Ser bise dhe Greqise. Kjo as ishte normale e as ndodhi.

Aresyet e nje qendrimi te tille duhen kerkuar ne fakte te tilla si: Valet e shumta te fiseve te ndryshme shqiptare te levizuara drejt Ju gut te Ballkanit (Rumeli, More, Ishujt Egje) gjate shekullit te trembedhje te, si dhe me vone ne vazhdim te shekujve. Asnje Grek nuk jetonte ne keto zona ne kete kohe ku mund te gjindeshin ose popullsi sllave, ose Grek fo les me origjine sllave te cilet ishin produkt i politikës Greqizuese te Pa

triarkanes se Konstandinopulit, institucioni qe i sillte me shume shqetesi me Perandorise Romake te Lindjes.

Shqiptaret u perzien me keto popullsi dhe shumica me e madhe e to ponimeve ne kete hapsire qe prej asaj kohe ishin sllave ose Shqiptare nga origjina. Gjate shekujve te gjate te Perandorise Otomane, administrata Otomane nuk beri ndonje kujdes ndaj politikës greqizuese qe drejtohte Patriarkana, Greket ishin me te shperndare ne fundin e shekullit te tetembedhjeve ne zona te ~~dyshtu~~ per shkak te ideologjise raciste te nje prifti anal fabet Shqiptar i cili e quente veten "Kosmas Etolian".

Per shkak te ketij fallsifikimi, "te gjithë" Kristianet e Kalifitet sidomos ata te Ballkanit, ishin Greke. Rezultat i ketyre levizjeve te popullsisë ishin formimi i nje numri te madh dialektesh, komponente kryesore te te cileve ishin Sllave, Shqiptare ose Vllah nga origjina. Pjeset e rendesishme te kesaj sasie te idiomave vendosejane Turke, Arabe ose Latine nga origjina, ndersa fjaltet me origjine Greke vijne vetem per shkak te perzierjes se te huajve (si p.sh. politikës se Patriarkanes), Asnje grek nuk ka mbetur ne Jug te Ballkanit; Grekefolesit nuk jane Greke.

Eshte shume e njohur politika kunder Perandorise Osmane e Britanise, Frances dhe Rusise ne Lindjen e Aferme. Politika ideologjike e "Civilizimit Greko - Kristian" ne nje shtet te vogel te quajtur Greqi, formuar me 1828 nuk la vend per ndonje gje tjeter te karakterit jo Grek me origjine ne Sllavo - Shqiptare te popullsisë se ketij shteti.

Mosrespektimi dhe perbuzja ndaj identitetit dhe origjines se nje populli eshte menyra me e mire e pozimit te injorancës dhe mosdijes se çeshtjeve te atij populli. Kjo politike eshte deshmuar ne shume raste dhe jo vetem ne Greqine moderne.

Greqia e kundërshtoi ekspansionin Italian ne Shqiperi, ne periudhen midis dy luftërave Botërore dhe veçanerisht pas vitit 1937. Qellimi kryesor i ketij kundërshtimi nuk ishte mbeshtetja per te Drejtat e Njeriut por te pozohet rreziku real ndaj Shqiperise. Ndonje lloj perpjekje kunder ketij vendi te vogel mund te ishte ndermarre prej Greqise ne se Italia nuk do te kishte interesa ne kete rajon. Per te parandaluar pushtimin e Shqiperise nga Greqia, Italianet do te bombardonin Korfuzin ne fundin e viteve '20.

Per me tej, fjalimi i pare i Kryeministrit Grek Georges Papandreu babai i Kryeministrit te sotshem Grek, Andreas Papandreu pas çlirimit te Greqise ne fund te vitit 1944 permante rreziqe te medha ndaj Shqiperise per shkak te ideve fallse te perhereshme qe Greket kane hedhur me kete çeshtje

Mardhenjet midis Greqise dhe regjimit komunist te vendosur ne Shqiperi u keqesuan dhe e gjithë kjo çështje mori te tatepjeten pas mbeshtetjes qe komunistet Shqiptarë i dhane komunisteve Greke gjate Luftes Civile Greke (1944 - 1949)

Vetem ne mesin e viteve `80, u arrit qe te hiqej gjendja e luftes se pashpallur midis Greqise dhe Shqiperise me ndihmen e Ministrit te Puneve te Jashtme te Papandreut, Karolos Papulias mbi bazen e idealeve te Botes se trete. Pas renjes se regjimit komunist, Shqiperia vazhdimisht eshte pare si nje arene e mundshme e ekspansionizmit Grek te viteve `90 qe kurse nacionalizmi i meparshem ishte i lidhur me obskurantizmin Ortodoks dhe me racizmin e perhershem Grek.

Nga ana tjetër, punetoret Shqiptare (Albanian Gastarbeiter) jane punetoret e huaj ndoshta me keq te paguar, me te fyer, me te shtypur e bile me te masakruar ne bote. Eshte kthyer ne nje hobi te policise Greke vrasja e Shqiptareve dhe fajsimi i "Mafias" inekzistente Shqiptare per incidentet.

Politika anti - Shqiptare, luftenxitesë e raciste e Ministrit te Puneve te Jashtme te Greqise e ka karakterizuar per nje kohe te gjate politiken e jashtme te Qeverise se Demokracise se Re ne nje mynyre fatkeqe e qesharake. Konstandin Micotaqis u perpoq t'i lidhte perspektivat e Kosoves me ekspansinin Grek ne Jug te Shqiperise, ne nje zone qe eshte quajtur ne menyre provokative "**Vorio Epiri**".

Ky eshte nje lloj oportunitizmi i qellimshem kur dihet se Shqiptaret Greke-foles ne Jug te Shqiperise nuk jane Greke, ndersa Kosovaret jane Shqiptare. Edhe me keq kur dihet se greqisht - folesit ne Shqiperi

jane minoritet, ndersa Shqiptaret ne Kosove perbejne padiskutim shumicen prej 95 % te numrit te pergjithshem te popullsise ne Kosove.

Qendrimit Grek ndaj Shqiptareve Greqisht - foles jane vertetuar ne pozicionet qe kane marre dhe interpretimet qe ata i kane bere ketij problemi. Administrata Greke e konsideron kete popullsi si Kristiane Ortodokse me shume se sa Greke. Ne fakt ky problem tashme eshte zgjidhur qe kurse

"**Vorio Epirotet**" shkuan ne Greqi per te gjetur pune dhe thujse me pak se 20.000 prej tyre mbeten ne kete zone.

Gjithë mardhenjet Greko - Shqiptare na ndihmojne ne analizen e faktoreve te vertete qe percaktojne politiken e jashtme Greke. Duke studjuar me kujdes ngjarjet dhe pozitat politike, ne arrijme te kuptojme se qendrimi anti - Shqiptar eshte marre ne fillim prej priftit te njohur Grek, Sebastianos i cili ka diktuar politiken e jashtme Greke rreth kesaj çështje gjate qeverisjes se dy kraheve qofshin ata te Demokracise se Re e

po ashtu te PASOK - ut.

Jane te shumte librat e botuar per kete çeshtje, bile edhe prej zevendesit te Ministrit te Financave Aleksandros Papadopoulos i cili eshte ekonomist. Kryesisht ato jane shkruar prej njerezish analfabete, ose prej njerezish qe kurre s`kane marre nje shkalle shkencore ne Universitet ne di siplinat perkatese, e megjithate keto libra propogandohen ne shtypin Grek nen kujdesin e posaçem te Kishes Ortodokse .

Çka eshte edhe me keqe nje reviste e permuajshme ka qarkulluar ne Greqi dhe duke perdorur emrin Hellopia, perpiqet qe te justifikoj riven dikimet Greke ndaj Jugut te Shqiperise. Nje pjese e te ashtuquajturve intelektuale ne Greqi guxojne te nenshkruajne e te publikojne artikuj ultra nacionalist. Kjo reviste ka qene subvencionuar prej Ministrise se Puneve te Jashtme gjate portofolit te Samarasit.

E pas kesaj vjen e keqja tjeter edhe me e madhe: Ne manualet pseu do - historike te shkollave te mesme Greke, lexuesit fatkeqe gjejne thirrje per "Clirimin" e Jugut te Shqiperise. S`eshte zor te konstatohet kontrolli i rrepte i Kishes Ortodokse mbi Ministrine e Aresimit.

Por çfare e ben te nevojshem institucionin racist e anakronik te destabilizimit te Shqiperise? Dihet se sa kohe qe kisha e jo shteti e trajtojne politiken e jashtme te nje vendi, çdo gje shihet nga pikpamja fetare çka tregon se nje lufte e shenjte po pergatitet aktualisht kunder Shqiperise, vendit te konsideruar si avanpost i "rrezikut islam". Dhe gjithçka e pergatitur dhe financuar prej Kishes Ortodokse.

Bashkepunimi normal dhe i domosdoshem midis Shqiperise dhe Turqi se eshte pare , prandaj, si nje "komplot islamik kunder Greqise dhe kristianizmit".

Histeria anti - Shqiptare e nacionalizmit ortodoks mund te shihet edhe ne poziten e tyre kundarshtuese ndaj politikës se te gjitha Qeverive te meparshme ne drejtim te Shqiperise. Ata i fajsojne ato per "lenjen ne harrese" dhe per perpjekje per te mohuar "te drejten" Greke per aneksimin e Shqiperine Jugore.

Perpjekjet per ta destabilizuar Shqiperine kane edhe nje aresye tjeter. Ky qendrim eshte konsideruar si mundesia me e mire per te shmangur pasojat serioze te perzenjes me dhune te shqiptareve nga Çameria. (tani e quajtur Thesprotia sipas emrit te vjeter, te harruar nder mijevjeçar dhe i risjelluar ne vitet `20 me qellim qe te "provohet" se ky vend ka qene tradicionalisht toke Greke, çka perben pa as me te voglin dyshim, nje fall sifikim.) Megjithate, çamet duhet te kthehen ne Greqi dhe po keshtu te drejtat e tyre dhe pasurite duhet tu rijepen.

Qendrimi agresiv anti - Shqiptar i Greqise spjegohet edhe me perpjekjet per te kapercyer problemet e diskriminimit te nje milion e gjysme Arvanitasve, pra minoritetit Shqiptar ne Greqi. Ata duhet te kene te drejten te ruajne gjuhen dhe kulturen e tyre (qe s`ka te beje aspak as me gjuhen e as me kulturen Greke) duke ndjekur shkollat fillore dhe te mesme ne Shqip (dhe jo ne Greqisht), te respektohet identiteti i tyre kulturor: aq i shperfillur e neperkembur ne Greqi.

#### 4.- MARDHENJET MIDIS GREQISE DHE SHTETEVE TE REJA NE TERRITORET E ISH JUGOSLLAVISE

Perpara se te merremi me mardhenjet dypaleshe te shteteve ish Jugosllave me Greqine, le t`i hedhim nje sy mardhenjeve te Greqise me ish Jugosllavine dhe si eshte pritur prishja e kesaj te fundit prej Grekerve.

"Aleanca tradicionale" Serbo - Greke e shekullit te nentembedh jete, ka qene nje realitet. Mbreteria e Jugosllavise mund te konsiderohet si nje vazhdim i shtetit te vogel Serb, per sa kohe qe shumica ne kete vend (si p.sh. popullata jo serbe) nuk lejohej te luante nje rol te rende sishem ne jeten politike e kulturore.

Duhet pranuar fakti qe Greket dhe Serbet disa here ishin aleate. E megjithate per nje historian eshte esenciale te perjashtoje argumentin e pavend te Kishes Ortodokse rreth aleances "shumevjeçare" ose "natyrale". E verteta eshte qe Greket dhe Serbet ishin njesoje te manipuluar prej Patriarkanes Ortodokse ne periudhen e erret te Perandorise Romake te Lindjes dhe ne periudhen e ndritshme Otomane.

Aleanca e tyre ishte e nevojshme, jo per te dy popujt, por per politiken anti - islame dhe anti Gjermane (Ne ate kohe Perandoria e Shenjte e Kombit Gjerman) te Patriarkanes. Qe te dy vendet ishin viktime te njetojta. Ne Lufterat Ballkanike dhe ne Luften e Pare Boterore, aleanca Greko - Serbe nuk ishte diçka normale, por ajo vinte si rezultat i bashkimit te te dy vendeve me Antanten. Gjate viteve `20 - `30 te ketij shekulli askush nuk fliste per kete aleance.

Ajo çfare ndodhi ne Luften e Dyte Boterore, i demtoi mardhenjet Greko Jugosllave; Komunistet Jugosllave te udhehequr nga Kroati Tito i ndihmuan komunistet Greke dhe i dhane fund zhurmave ultra - nacionaliste Serbe. Ata i njohen te gjitha minoritetet e vendit, ju dhane te gjitha Te Drejtat e Njeriut per te gjithet, duke i konsideruar pjese te Serbise edhe Shqiptaret (Kosova) edhe Inqedonet.

Formimi i Republikës Socialiste të Maqedonisë ka ndihmuar për të nxjerre në pah qendrimit kriminal të qeverisë monarko - fashiste Greke ndaj minoritetit Maqedon në Greqi. Me se 100.000 maqedonas të Greqisë gjeten atje një mënyrë për të shpëtuar pasi Greqia e fundit të viteve '40 u kthye në një ferr si për demokratet ashtu edhe për komunistet maqedonas.

Mardhenjet e keqja Greko - Jugosllave vazhduan deri më 1975, por "Ostpolitika" e Karamanlisit kishte nevojë për përmirësim të tyre për arsye të keqesimit të mëtejshëm të mardhenjeve Greko - Turke. Për të siguruar këto përmirësim, politikanet dhe shtetaret Greke e pranuan qenjen e kombit Maqedon sado që taktikisht.

Tani ata akuzojnë njëri tjetrin për këto, duke thënë se ata e pranuan këto emer kur Maqedonia ishte një shtet i "Federatës" dhe jo një shtet i pavarur. Kjo është padyshim një absurditet pasi s'ka asgjë të bëjë me ekzistencën e një kombi të cilin Greket refuzojnë ta pranojnë.

Shpërberja e federatës Jugosllave ishte pa dyshim një nevojë pasi që Serbet ia dolën të vënë nën kontroll totalitar dhe aspak demokratik administratën dhe të ushtrinë e pas Titos. Një gjë e tillë u përçoll me shumë shqetësim në Greqi. Ajo ishte një si paralajmërim për mundësinë e shpërberjes së Greqisë (Turqit në Trakine Perëndimore, Maqedonit në provincën Greke të quajtur Maqedoni, Shqiptaret në Epir dhe Etoli, minoriteti vllah në Thesali dhe në provincën Maqedono - Perëndimore, të grekëve katoликe Romake në Cyclades dhe së fundi Kretasit, një popullsi jo Greke Semitike në Kretë) në të cilën ekziston një lëvizje separatiste e bazuar mbi argumente historike, politike, kulturore dhe ekonomike.

Intelektualet Greke, shtetaret, priftet dhe politikanet reagojnë në mënyrën më të keqe duke shprehur frikë dhe injorance rreth shpërberjes së Jugosllavise. Ata u përpoqën të "interpretojnë" shpërberjen e Jugosllavise në një mënyrë të tillë që tu shkonte interesave dhe ideve të tyre të prapambetura.

Ky "interpretim" u shpërnda nëpër tërë Greqinë (në arsim, në mas media, dhe tekste) pa ndonjë kundërshtim të mundshëm, meqenëse për një kohë të gjatë regjimi totalitar Grek kishte ndaluar përhapjen e ideve të ndryshme, interpretimit të fakteve, argumenteve dhe analizave të ndryshme. Shtyllat kryesore të interpretimeve fallse janë:

a) Fuqite e Medha gjithmonë shfrytëzojnë vendet e vogla.

b) Vendet e vogla janë, prandaj të detyruara të refuzojnë nderhyrjen ekonomike të Fuqive të Medha. (Kjo bëhet edhe në botën e sotshme të ekonomisë së tregut të lirë, edhe atëherë kur kjo ndihmon progresin e vendeve të vogla).

c) Vendet e vogla janë "të pafajshme" dhe nuk deshirojnë kurrë të

Zhvillimet e fundit ne Ish - Jugosllavi dhe çeshtja e mirenjohur Duroselle ka sjelle nje anti - Europeanizem te thelle, anti - Oksidentalizem, dhe anti - Kozmopolitizem qe i ndihmon izolimit te vendit. Nga ana tje ter kjo shkaktoi shqetesime brenda vendit per sa kohe qe ajo behet nje pengese per kuptimin e vertete te rendesise se Islamit per Evropën.

Europa ka reaguar ndaj kesaj duke e shtyre Greqine drejt nje izolimi te metejshem, megjithese kjo eshte e dyshimte se sa kjo e ndihmon ke te izolim. Deri tani, izolimi i vendit i ndihmon vetem udheheqesit Greke te ndjekin politiken e tyre te perpjekjeve per te ndryshuar Historine e Botes dhe te parandalojne rrjedhjen drejt tyre apo perhapjen e informacionit te vertete.

Çeshtja Duroselle, megjithate ishte krej indikative: Libri i J.B. Duroselle, eshte subvencionuar prej Komisionit te Bashkimit Evropian, shkruar ne gjuhen Frengje dhe perkthyer ne te gjitha gjuhet e Bashkimit Evropian me perjashtim te asaj Greke. Eshte e kuptueshme qe ai eshte shkruar per nje publik mesatar duke u bere i pari (i tille mbetet ende) ne llojin e vet te ideologjise Evropiane si dhe te justifikimit historik te riunifikimit te sotshem Evropian.

Siç mund te kuptohet libri ishte nje kerkim per nje Ideal Evropian neper histori dhe jo nje analize dhe sinteze konvencionale historike. Shume akademike, profesore, studjues, intelektuale, shtetare historiane dhe studjues te politikës kane publikuar shenime te shkelqyera dhe komen te rreth tij. Ai eshte perkthyer gjithashtu ne te shumten e gjuheve te Evropes Lindore.

Por ne Greqi ai eshte konsideruar si **"fallsifikim i historise"** dhe si "perpjekje Sioniste per te minimizuar rendesine e Greqise ne formimin e Evropes" Mjafton te themi se ajo çfare Prof. Dr. J.B. Duroselle i cili eshte nj akademik, intelektual dhe studiues i shkenca ve politike, beri, ishte thjesht ajo qe ai nuk ka marre ne konsiderim nivelin e ulte historik te fallsifikimeve te perhapura ne Greqi si "histori".

si rezultat i te gjitha ketyre zhvillimeve, pseudo - teorite dhe fallsifikimet jane shperndare ane e mbane Greqise per te permiresuar idene te cilen Grekerit e meparshem kishin rreth Jugosllavise. Atehere teoria fallse e "fuqise ndermjetese" zhvillohet: Serbia (dhe per pasoje Greket) do te qendronin ne nje pozicion te ndermjetem midis Lindjes e Perendimit.

Per rastin e Serbise ata sajojne nje shpikje te re: nje pozicion midis Romes dhe Perandorise Romake te Lindjes (gje qe nuk tregon per nje pozite te ndermjeteme), ose bile nje pozicion midis kapitalizmit dhe socializmit. (ne lidhje me kete mund te thuhet se ka vende me pozite te "ndermjetme" si Shqiperia, Suedia, Iraku, Algjeria, Kuba, Kina, Angola, Abissinia e keshtu me radhe).

Nuk mund te mohohet fakti se: eshte e rrezikshme per nje regjim totalitar per te zene ose nje pozicion ekstrem te vertete ose nje pozicion ndermjetes fiktiv. Idea rreth pozicionit Grek te ndermjetem eshte de shumuar here pas here ne sistemet ideologjike fashiste.

Ne ditet tona, e permuejshmja "Davlos" perhap ide te tilla duke qene propoganduesja kryesore fashiste ne Greqi. "Davlos" (Pishtari) ka patur influence midis deputeteve te Demokracise se Re (partia e djathte) si dhe tek shume akademike, (G.Karagounis), E.Moutsopoulos), profesore (G.Costas, A.Zoubos) deputete (A.Synodinou) dhe "intelektuale" te ciletikane afruar kontributin e tyre, kesaj gazete.

Eshte e mjaftueshme te themi se sipas "Davlos" zotat e Grekerve te lashte (Zeusi, Atena, e te tjeret si keta) nuk ishin zot (dhe nuk u besoheshin si zota ne kohet klasike), por ata ishin "mbreter historike" te nje periode historike qe shkon prej 15.000 vjetesh p.e.re deri tek vitet 10.000 po p.e.re. dhe ata besoheshin si Greker te lashte.

Sipas kesaj reviste qesharake kjo "e vertete historike" ishte reduktuar ne mitet, vetem per shkak te komplotit te mbartur prej Sionistev dhe masoneve te lire te kohes se Aleksandrise Romake. Kjo marrezi foshnje re besohet si "e vertete" prej deputetesh si Fr.Tsagaris, G.Andreoulakis,

G.Cammenos, A.Synodinou, S.Couvelas, J. Kefloyannis e te tjereve qe u takojne Demokracise se Re dhe gjithashtu S.Papathemelis, M.Haralambis V.Vounatsos (i vete shpallur ne menyre provokative si "Deputet i Imbros" "Deputet i Gökçeada" te cilet i takojne PASOK - ut.)

Te gjitha keto ndihmojne ne pregatitjen e nje sfondi per vazhdimin e goditjeve ndaj Evropes. Deklarata e pare e Papandreut pas rizgjedhjes se tij vitin e kaluar ishte nje perpjekje e mprapshte per te fajtuar Evropën per shperberjen e ish Jugosllavise. Kjo tregon mangesi te plota te aftesise per te analizuar dhe kuptuar shkaqet e verteta te asaj çka ndodhi. (kontrolli totalitar Serb mbi administraten dhe ushtrine, shtypjen e shumices se popullsisë se vendit prej tyre.)

Mbreteria e Jugosllavise ishte nje krijese artificile, nje fabrikim i Frances pas Luftes se Dyte Boterore, çka perbente nje menyre per te shkaterruar Perandorine Austro Hungareze te Evropes Qendrore.

Eshte per kete arsye qe propoganda Serbe eshte pranuar ne Greqi, ne kete vend ku asnje ide nuk tolerohet. Ajo rezulton keshtu ne nje fallsifikim te historise: atje (ne Serbi) ishte e nevojshme te ndiqej nje politike armiqesore kunder Kroateve, Boshnjakeve dhe Shqiptareve per shkak te "bashkepunimit" te ketyre popujve me okupatorin Gjerman dhe vrasjen e Serbeve, gjate periudhes se okupacionit Gjerman.

Kjo gje eshte absolutisht qesharake dhe e pagene. Por edhe ne se ka ndodhur ajo duhej harruar. Aq me teper, politika e Titos ka pase pushuar se qeni "anti - Serbe" qekurse ai e minimizoi rolin e Serbeve. Ky eshte nje fallsifikim tjeter qe eshte perhapur ne Greqine e sotshme dhe qe ndihmon ne shtremberimin e realitetit dhe e ben popullin Grek t'i kuptoje ngjarjet nderkombetare sipas nje koncepti racist e fashist.

Por le t'i shohim tani mardhenjet ne planin e tyre dypalesh:

#### 4.1 MARDHENJET GREKO SLOVENE

Greqia ka qene e detyruar qe te njihete Slovenine bile ende vazhdon ne Greqi debati ne se duhej njohur Kroacia dhe Sllovenia ne vendimin e Komunitetit Evropian me 16.Dhjetor 1991 apo duhej vendosur vetoja per mos shperberjen e Jugosllavise. Kjo tregon se sa artificial eshte debati politik ne Greqi dhe se sa mbrapshte mund te kuptohen pozitat politike te Greqise brenda Bashkimit Evropian. Pervec kesaj, idea Slovene e mosqenjes se Slovenise nje pjese e Ballkanit eshte pritur si nje ide raciste prej Grekerve.

#### 4.2 MARDHENJET GREKO - KROATE

Kroacia mbahet tani prej Grekerve, ne qendrimet e tyre te mirenjohura per te tejthjeshtuar çeshtjet si "Papa i Ballkanit". Kjo i nevojitet administrates fashiste e raciste per ta shperndare ate ne popull. Greqia po ashtu ka qene e detyruar te njihete Kroacine por mardhenjet kane qe ne tejet te varfra dhe kjo pa dyshim si rezultat i qendrimeve me te fundit pro Serbe dhe tradicionalisht anti - katolike te Grekerve ndaj shtetit modern Kroat.

Greket janë gati të pranojnë bashkimin me forcat e Krainës dhe Kninit me Serbinë (aktualisht një territor i pushtuar), por jo edhe të Kosovës me Shqipërinë.

Në rastin e luftës midis Kroacisë e Serbisë, zhvillimet e reja janë në dëshmuar në qëndrimet dhe pozitat politike të marra prej Greqisë: Gjermania, Franca, Britania, Italia dhe mas-media ndërkombëtare janë akuzuar për "**komplot antiserb**". Ky fallsifikim fenomenal me vone është dëshmuar në rastin e invazionit Serb në Bosnje; vetë bashkësia ndërkombëtare është akuzuar për "**komplot anti-serb**".

Kjo ide ndihmon me tepër në izolimin e Greqisë "**vendit të pa ve llezër**" sikundër është shprehur në mënyrë gësheqarake ish presidenti Sardi takis. Po që se politikanët Grekë dhe mas-media nuk do të merrnin këtë qëndrim ata do të hapnin shteg për shkaqe të vërteta të luftës, si bje fjala kontrolli Serb mbi ushtrinë dhe arsenalin ushtarak federal (mbi 80 %) dhe thirrjet fashiste për "**Lebensraum**" (e thirrur për turp si "Serbia e Madhe")

E gjitha kjo rezultoi në fajësimin e Papës në një përpjekje për të "krijuar Kroacine nëpërmjet të luftës" (!) dhe në identifikimin e Kroatëve të sotshëm me disa grupe politike anësore të kohës së Hitlerit (ustashët); Me e keqja e të keqëve, Kroatët janë përshkruar si "një rezultat anormal i zhvillimit të kombit Serb".

Sipas pikepamjes Greke, Kroatët duhej të ishin Ortodoksë dhe jo Katolike, si rrjedhojë "**Serb të vërtetë**". Kjo edhe me tepër vlen në rastin e Bosnjakeve.

Me sa duket kjo është edhe arsyeja pse interpretimet historike të konsiderueshme mbi mundësinë e origjinës Iraniane të Kroatëve janë "vënë në lojë" prej personave jo specialiste në Greqi. Pa asnjë referencë në burimet historike dhe bibliografike ndërkombëtare, Dimitris Costopoulos, ka botuar një libër i cili është i mbushur plot me gabime historike (numërohet të këte jo më pak se 10 të tilla për çdo faqe) dhe mohon interpretimet e fundit të studjuesve dhe analizat për origjinën Iraniane të Kroatëve pa pas lexuar ndonjë gjë të botuar për këte çështje. Është e qartë se ky interpretim nuk i shkon për shtat pasaktësive pro-Serbe të botuara prej kriptom-fashistit të degjuar Lukas Akselos, botues i revistës shoviniste "**Tetra dia**".

#### 4.3 MARDHENJET GREKO BOSHNJAKE

Ne kete rast duhet te analizohet nje urrejtje tradicionale: Ori gjines se Boshnjakeve i jane rikthyer shume here dijetaret; duke ndjekur nder shekuj (shek. 7 - 9) grindjet per perfytyrimet qe zene fill ne Anato li (ne Greqisht, Eikonomachia), nje numer i madh grupesh ideologjike shi het te jene formuar. Paulicianet, te cilet mbajne flamurin e kundershiti mit te perhershem te idhujve brenda kornizes se kristianizmit, kane qene jashte zakonisht influencues ne zonen qe sot thirret Malatia, me perpara se ata te ishin transferuar - te pakten pjeserisht - drejt Balkanit Qendror prej Perandorise Romake te Lindjes.

Atje e kane prejardhjen Bogomilet, te cilet me vone influencuan Kataret (Cathars) ne France e Spanje

Puna e shkelqyer e St. Runciman ne Manikeizmin (Manichaeism) ishte krejtesisht informative ne kohen e tij, por gjithçka eshte analizuar tash vone. Eshte pra e vertete qe Bogomilasit jane stergjysherit e Boshnja keve. Kjo provon origjinen Anatoliane te Boshnjakeve, por nje e vertete e tille nuk mund te qarkulloje ne Greqi ku Boshnjaket konsiderohen si nje dege tjeter anormale Serbe(!) si p.sh. Serb te cilet perqafuan Islamin. Esh te e vertete qe ka Boshnjak me origjine Serbe dhe po keshtu qe Serbet jane kthyer ne Muslimane.

Eshte megjithate krejt e pamundur per Greket qe te pranojne kete ndodhi historike pasi ka nje paralele qe nuk pershtatet per ta: Ceshtja e miliona Grekerve te cilet u kthyen ne muslimane pas shekullit te 10-te e qe sigurisht, askush nuk guxoi te flase per ta ne Greqi, e qe atehere the melet ideologjike te shtetit modern Grek kushtezuan kundershitim e perher shem te Islamit;. Greket sot pranojne se ekzistenca e shtetit te tyre esh te "nje justifikim historik" i kundershimit te perhershem te Islamit dhe i qendrimeve te tyre teorike e praktike reaksionare.

Duhet shenuar gjithashtu qe administrata Greke gjen nje argument te rendesishem ne rastin e ish Republikes Socialiste te Bosnjes. Qyshse em ertimi "Boshnjak" u perdor ne sensin e vet gjeografik, administrata e Ti tos e perdori emertimin "Musliman" per Boshnjaket per te bere dallimin e tyre me minoritetet Serbe e Kroate ne Bosnje. Ky e perdori fjalen Musliman si nje realitet etnik e kulturor me prejardhje nga idea Greke e te quajtu rit "Musliman" Turqeve te Thrakes Perendimore. Sidoqofte e verteta eshte se i vetmi "Komb Musliman" qe ekziston eshte "Dar al Islam" ne sensin e tij te plote, ndersa ky term perbledh te gjithe popujt muslimane.

Bosnjaket janë konsideruar si një rrezik prej administratës Greke pasi që ekzistenca e një shteti Musliman në Ballkan nuk mund të pranohej prej Kishës Ortodokse Greke. Për shkak të injorancës që mbretëron në Greqi termi Islam (një term fetar) dhe Islamizmi (një ideologji dhe sistem politik modern i pranuar prej një pakice të sotshme muslimane) po aq sa edhe termat Islamik e Musliman kanë qenë dhe janë ngatrruar e shfrytëzuar prej Kishës Ortodokse Greke. (për një paraqitje të gabuar të luftës për jetën të Bosnjakeve si një "luftë të shenjta anti kristiane")

Interpretimet fallse dhe teoritë rreth rrezikut eventuale të fondamentalist prej Republikës Islamike të Bosnjës e kanë prejardhjen prej ndihmave të afëruara për Bosnjën nga Turqia, Arabia Saudite, Irani dhe Libia. Se si shtremberohet problemi i Islamit në Greqi, mjafton të përmendim faktin se në asnjë Universitet Grek nuk ka të paktën një departament të studimeve Islamike. Është vetëm një teolog Kristian, Konstandin Patelos (Constantine Patelos) i cili në fillim ishte emëruar si lektor dhe më vonë u gradua në pozitën e profesorit të Universitetit të Panteios në Athinë.

Ai e ka mesuar Historinë Politike të Arenës Islamike, edhe përkundër faktit që ai kurrë nuk e studjoi Islamit qoftë edhe në vitin e parë të Universitetit ndërkohë që nuk kupton as Arabisht, as Farsçe (Gjuha e Iranit), as Turqisht e as gjuhën Urdu (gjuha e folur në Pakistan) Ai ishte i detyruar sipas ligjit diktatorial që u vendos gjatë kohës së sundimit të Juntës Ushtarake (1967 - 1975), të botonte një manual për këtë çështje për të gjithë studentet që do të mund të riprodhonin nga një manual të vetëm (afëruar prej profesorit të tyre) për kurs por jo me referencë bibliografike.

Ky manual përmbante shtremberime dhe falsifikime të paprecedencës; Profeti Muhamet "reduktohet" në nivelin e "mbledhësive fallse të elementeve të tjera fetare".

Në manualin e tij të gjeshtert, gati në çdo faqe mund të gjesh gjepura femijerore si p.sh. në të thuhet se Gadishulli Arabik ka "klimë tropikale" (!) pasi "kryqëzon me Ekuadorin": Ky profesor qëndron në të tijen edhe përkundër botimeve tepër të veshtira të mijat në vjetoret, gazetat etj; edhe përkundër botimeve të tjera në vjetoret shkollë, edhe përkundër letrave të panumerta denuese të dërguara prej Ligës Botërore Muslimane dhe institucioneve të tjera, Po kështu edhe profesore të tjera të Universitetit Panteios nuk u janë përgjigjur letrave e thirrjeve të panumerta që kërkojnë shpjegimin e çështjes çka përben një përpjekje kriminale për të errësuar të vertetën mbi Islamit brenda kontekstit të Universitetit. E gjithë kjo ka të bëjë me tepër me idenë e një personi medioker sa i takon problemit të Islamit në Bosnje.

Por çka është edhe me keq është gezimi Grek për masakren Serbe në Bosnje. Duke e ndjere bezdine e diskutimeve për përqindjet e Boshnjakeve në Bosnje pasi kjo ka të bëjë edhe me situatën në Trakine Perendimore, të bindur se e gjithë Bosnja do të jete pjesë e Serbise, administrata Greke e bashke me të popullin i keqinformuar kanë ndjere kenaqesinë e të vezhguarit të asaj që po ndodh me Boshnjaket që është ajo që ata do të deshironin të bënin në Trakine Perendimore por që nuk janë të zotët ta bëjnë.

Ata flasin për "luftën e tre gishtërinjëve", luftën kriminale Ortodokse kundër Islamit, pasi këta gishta ndihmohen në formimin e Kryqit Ortodoks si simbol. E kështu ata janë të lumtur tek i shohin Boshnjaket "të humbur" dhe atëherë fillojnë të mejtojnë që Ortoksia do të "zhduke" Islamin, të përzejnë Turqit prej Greqisë ose ta bëjnë Stambollin "Ortodoks Grek" perseri.

Në një kontrast të plotë me të gjithë popujt e civilizuar të botës, Greqët derguan ndihmë Serbeve dhe jo Boshnjakeve. Greqët refuzojnë të pranojnë realitetin shumë kulturor në Sarajevë, çka është një prej çështjeve më të rëndësishme në çdo pjesë të botës së sotshme.

Karakterit multikulturor i botës së sotshme, ideali i multikulturizmit, dhe afrimi multikulturor i Historisë Botërore, konsiston në kontributin më të mirë të Evropës Moderne në historinë e botës ndërkohë që kundërshtimi Grek bëhet një rrezik serioz për unifikimin e kontinentit Evropian dhe për perspektivat e paqes në botë.

Kësaj pamjeje mund t'i shtohet histeria Greke kundër paraqitjes së drejtperdrejte të mas medias botërore të krizës Boshnjake dhe përpjekja Greke për të shfrytëzuar politiken e jashtëmë Ruse (ose të pakten idetë për një politikë të jashtëmë Ruse të paraqitura nga njëri prej si Zhirinovski) kundër Islamit. Pas kësaj çdokush sheh një panoramë të një paranoie obskure antiste që duhet të shqelmojë jashtë Evropës sa më shpejt të jete e mundur.

#### 4.4 MARDHENJET GREKO - KOSOVARE

Edhe pse Micotaqi dha sinjalet e një trajtimi të problemit të Jugut të Shqipërisë të lidhur me atë të Kosovës Greqia e ka mbeshtetur me tërë përziemërsinë shtypjen e tmerrshme Serbe në këto zone duke pranuar pikepamjen krejtësisht të pabazë dhe idetë raciste të Serbeve se Kosova na qenka Serbe "qysh në kohët e lashta"(!).

Por kjo nuk është çështja më e madhe. Ajo ka lidhje me thirrjet Greke për Maqedoninë, Shqipërinë, Qipron, Trakine dhe Detin Egje. Botës së

qyteteruar i duhet sjelle nder mend se ekspertet me te keqinj te politikes raciste Serbe jane ata per Kosoven.

Eshte folur shume rreth disfates historike, 13 qershorit te vitit 1389 (Bosko Jugoviç), rreth Manastirit te Deçanit, dhe varrit te Shenjtit Uro Decam (vdekur me 1327), i cili mallkonte çdo Serb qe do te behej musliman, shtremberimeve rreth figures se Princit Llazar etj. Siç dihet, sentimentalizmi i perzier me falsifikimin e historise pergatit amalgamen me te efektshme eksplozive te histerise raciste.

Greket e pranojne idene Serbe te dy kombeve qe jetojne ne Kosove, kur ne te vertete atje ekziston vetem nje qe jane Shqiptaret qe perbejne me se 95% te popullsisë lokale. Gjithashtu, Greket pranojne propoganden Serbe qe i referohet identifikimit te Kosovareve te sotshem me mbeshtetesit e "Ballit Kombetar" gjate okupacionit Gjerman. Ne rastin e shtypjes ndaj shqiptareve mund te shihet e njejta kenaqesi qe Greket kane per rastin e masakres se ndermarre kunder Boshnjakeve.

Turqia eshte akuzuar aq shume si zjarrefryrese e krizes ne Kosove dhe te gjitha fyerjet e ulta e aspak dinjitoze te Serbeve ndaj Presidentit te guximshem Kosovar Ibrahim Rugova jane perdorur edhe prej Grekerve. Kjo nuk duket aq e çuditshme po te shohim se ekzistojne te njejtat mungesa edukative, kulturore, te njejtat karakteristika etnike si tek policet Serb edhe tek intelektualet Greke po ashtu.

#### 4.5 MARDHENJET GREKO - MALAZEZE

Mali i Zi per shume kohe eshte konsideruar si i "pa rendesishem" edhe perkunder aleances anti - Shqiptare, Greko - Malazeze e cila i ka shkaktuar aq shume probleme Shqiptarve me 1913 - 1914. Gati çdo njeri ne Greqi beson se Mali i Zi duhet te jete pjese e Serbise: Derisa nje numer i madh politikanesh Malazeze deshironin ndarjen nga Serbia dhe me rivendosjen e karakterit racist te Jugosllavise se re, shume politikane Greke, profesore, prifterinje dhe "intelektuale" filluan te flasin per nje tjetere levizje "anti Ortodokse"

Midis tyre nje eshte qe dallohet me teper, C.Holevas, profesor ne Universitetin e Panteios dhe djale i ministrit te Juntës ushtarake i cili meson se interesat e politikës se jashtme Greke munden me qene vetem ato çka i nevoiten kishes Ortodokse duke lene te kuptohet i njejti kurs edhe per Malin e Zi. Si edhe pjesa me e madhe e pseudo - intelektualeve qe i shkojne pas neo - Ortodoksizmit te sotshem si psh. Chr.Yannaras, G.Zouraris dhe G.Metalenos, C.Holevas nuk ka ndonje kredibilitet akademik!

#### 4.6 MARDHENJET GREKO \_ VOJVODINASE

Nje mungese e plote informacioni dhe njohjeje per Vojvodinen aq sa edhe per komunitetet Hungareze e Rumune atje e karakterizon opinionin Grek. Greket sigurisht qe do te kundershtonin ndonje perpjekje per pamvare si te Vojvodines.

#### 4.7 MARDHENJET E GREQISE ME SANXHAKUN

Greket jane te panjohur me te verteten ne Sanxhak po aq sa edhe me nevojen e shumices se popullsise lokale per te fituar pamvaresine. Mus limanet e Sanxhakut mund t'i bashkoheshin Bosnjes, Shqiperise e Kosoves por edhe kjo do te perceptohet gjithashtu si nje tjeter rrezik per Greket.

#### 4.8 MARDHENJET GREKO - SERBE

Sipas Grekerve, Sanxhaku, Vojvodina, Mali i Zi, nje pjese e madhe e Bosnjes dhe e Kroacise duheshin lene brenda kufijve Serbe. Ky nuk eshte nje trill; eshte "Serbia e madhe" nje realitet i turpshem i te sotshmes per te cilin çdo kushi sadopak i civilizuar shpreson se nje fund i shpejte do ti vije asaj.

Siç eshte permendur edhe me pare ne kete material, mardhenjet Greko Serbe kane patur edhe keqesimet e tyre ne aspekte te ndryshme - çka nuk jane pak - si ne jeten politike, intelektuale dhe ate kulturore. Nensh tresat barbare te kultures Serbe si dhe nacionalizmit te tyre Kristian Ortodoks kane nje ndikim te jashtezakonshem ne nacionalizmin Grek dhe tek disa shtylla te veçanta te fabrikimit te ideologjise fallse qe eshte quajtur "Qyteterimi Greko - Kristian"

Alëanca e sotshme Greko - Serbe mund te studjohet ne disa aspekte te saj:

1. Serbia dhe Greqia konsiderohen si "tokat e historise", pjesa tjeter e botes eshte e privuar nga nje privilegj i tille.
2. Nacionalizmi eshte i lidhur me Ortodoksine ndersa e verteta historiike eshte ndaluar ne te dy vendet.
3. Karakteri racist i Ortodoksise po aq sa edhe versioni i Historise se Botes vjen per shkak te mungeses se karakterit universal. Ky besim nuk ka apel universal. Mjafton te studjojme diskurset politike te Peshkopit Yeftiç ose formulimin e varfer te librave te peshkopit Grek te Lerin Florines, Cantiotis.
4. Refuzimi ndaj "te tjereve" dhe "te atyre qe jane te ndryshem" e ben ndonje pastrim etnik dhe diskriminim kulturor nje nevojje per te dya

edhe per Serbine edhe per Greqine. Pas te gjitha ketyre praktikave kriminale vetem izolimi mund te perftohet. Ajo çka bie ne sy eshte fakti se ky afrim nuk eshte praktikuar vetem ne periudhen e Mesjetes Ortodokse ose gja te kohes se Perandorise Romake te Lindjes, kur te gjitha grupet etnike kon sideroheshin si peranuese te mundshme te idealeve kristiane.

5. Ka nje fokus te histerise anti - Islame ne te dy vendet. Per te nxitur praktika te tilla, te dy palet riprodhojne interpretime te ideve te vjetra sipas te cilave Islami eshte "Shpikje e djallit".

6. Bashkepunimi Greko - Serb kufizon mundesite e afrimit te verte te per zhvillim. Greket nuk mund te pranojne te verteten tragjike te historise se familjes fatkeqe te Milosheviçit qe kishte pos gjithë te tjera ve edhe goditjen traumatike psikologjike te tij (Milosheviçit)

Bile edhe me keq se kaq, ky bashkepunim i shtyn keto dy vende te lidhura ngushte me njera tjetren te thellojne marrezite si bje fjalë, diskutimet rreth nje pushtimi te mundshem te Maqedonise, rreth nevojës se bashkimit te kufijve midis Serbise e Greqise, riformimi i nje Perandorie Serbo - Greko - Neo-Bizantine. Kjo politike eshte nje perpjekje serioze per te destabilizuar te gjithë rajonin e Ballkanit, Shqiperine, Kosoven, Maqedonine, Bullgarine, Bosnjen Sanxhakun dhe Turqine.

Greket kane perseritur fyerjet Serbe ndaj luftetareve muslimane ne Bosnje (**muhaxhidinet hashash pires**) e ne te njejten kohe kane vezhguar e dhe zhvillimet e metejshe ideologjike. Zgjedhjet ne Serbi dhane "nje mandat historik" duke gjetur ne verberine e ideve centriste Greke qe i karakterizojne te gjitha Partite e ketij vendite njejten mbeshtetje. Edhe me keq se kaq Greket jane ne gjendje te bëjne pyetje te pabaza e fallse te cilat Serbet i kane bere vitet e fundit: "Si mundet nje vend i vogel prej dhjete milionesh te jete nje rrezik per boten?"

Kjo ndihmon te fshihet aspekti totalitar i karakterit ideologjik dhe jep nje sentence pafajsie. E megjithate ajo eshte teorikisht nje çeshtje e gabuar pasi rreziku nuk eshte çeshtje e miliona njerezish por çeshtje e karakterit racist te nje sistemi ideologjik. Ne fillesen e vet ky rrezik nuk ka aspak te beje me numrin e madh te njerezve.

Ne Greqi, aleanca Greko - Serbe shihet si e vetmja mundesi per te ndjekur politiken tradicionale anti - Turke. As edhe nje politikan i vetem nuk mund te shpetoje ne se guxon ta atakoje kete politike. Vetem Bashkimi Evropian mund te jete ne nje pozite te tille qe te detyroje Greqine per te

shkaterruar lidhjet e saj me Serbine. Komisioni i Bashkimit Evropian do të mund të ushtronte ndonjë lloj presioni për të detyruar Greqinë që të heqë dorë nga kjo politike e marre e luftënxitese në Ballkan. Kjo duhet bërë me njëherë. Nesër do të jete vonë për të gjithë.

#### 4.9 MARDHENJET GREKO - MAQEDONASE

Në këtë rast ne shohim shprehjen me autentike të ideologjive raciste centriste - Greke në fushën e politikës së jashtme. Maqedonia moderne konsiderohet në Greqi si një krijesë artificiale, një "fabrikim", që s'ka aresye të ekzistojë.

Po t'i shohim gjerat në anet e tyre të përbashkëta, atëherë do të vëne re se Greqët nuk tërheqin të njëjtin konkluzion në lidhje me vetë Greqinë, ndonëse shumë studiues kanë theksuar se formimi i Greqisë moderne nuk korrespondon me ndonjë lidhje autentike të popujve në rajonin në fjalë. Greqët i humbin kontaktet me realitetin kur pretendojnë se nuk ka patur kurrë në Maqedoninë e sotme, popull sllav - Maqedon me gjuhë, kulturë dhe identitet.

Shtjellime me të hollësishme mund të gjinden në botimet Greke rreth historisë së lashtë të popullit Maqedonas. Stergjysherit e Maqedonasve janë quajtur gabimisht Greke. Ata kanë gjuhën e tyre e cila nuk është ruajtur në ndonjë numër të madh dokumentash të shkruara. Ka patur përpjekje për të observuar shkrimin Maqedonas me germa Greke. Po kështu vihen re edhe fjale të vjetra Maqedone të përdorura në tekstet Greke.

Demosteni spjegon mjaft qartë karakterin jo Grek të Maqedonëve të lashtë. Por pseudo - studiuesit Grek si M. Sakellariou pretendojnë se Greqët e lashtë ishin vazhdimisht të angazhuar në luftën vllavrasëse duke fyer njeri tjetrin. Megjithatë dihet se sipas Demostenit, Spartanët dhe Korinthasit (Për kohë të tëra armiq të Athinasve) konsideroheshin "Greke" ndërsa Maqedonasit nuk konsideroheshin të tillë.

Origjina e Maqedonasve dhe e Dardaneve është Anatoliane ndërsa emri i Maqedonisë nuk ka asgjë të bëjë me Greqët, sikundër studiuesit Grekë përserisin krejt pa baze. Ideologjia politike e Mbretërisë Maqedone është pa as me të voglin dyshim, jo - Greke; simboli i tyre me 16 rreze dielli në flamur nuk është një simbol i lashtë Grek dhe origjina e tij Firygjene (Phrygian) mund të rikerkohej perseri.

Greket dhe Maqedonet konsideroheshin si dy grupe krejt të ndryshme në Egjipt, ku Ptolemejtë, një dinasti Egjiptiane me origjinë Maqedonase përgmonin ideologjinë Greke; ata ndertuan marrëdhënie të ngushta kulturore Egjiptiano - Maqedonase.

E gjithë kjo e vertetë historike ka qenë e ndaluar në Greqi në një mënyrë vertetë diktatoriale e totalitare, dhe që më 1974 qoftë edhe një pjesë e punimeve të Demostenit për kurset e Lashtesisë Greke nuk është mesuar në ndonjë Fakultet të letrave në Universitete Greke. Kush nuk e di që Maqedonet nuk moren pjesë kurrë në lojrat Olimpike ~~ku~~ vetëm Greket ishin të pranuar ?

Procesi i gjatë i greqizimit historik, kulturor, fetar dhe gjuhësor të Maqedonëve (350 - 200 p.e.re), latinizimit, (200 p.e.re - 330 e.re) kristianizimit (330 - 600) dhe slavizimit (600 - 900) nuk është pranuar asnjehere, proces shumë pak i përhapur tek Greket. Kjo lidhet edhe me procesin e slavizimit të provincave Romake të Ballkanit të Jugut gjithashtu.

Tekstet e sakta historike të cilat flasin për sllavizimin e plotë të Morenes janë fshehur dhe mohuar në mënyrë të pa baze prej Bizantinistëve të sotshëm Greke ndërsa Fallmerayeri, historiani i shquar i shekullit të nëntëmbëdhjetë shpesh është fyer në mënyrë të shëmtuar tipike Greke.

Çka është më e keqja Greket e sotëm i bazojnë argumentet e tyre të pasakta e fallse mbi gjithë historinë Greke në të dhjetë volumet e vepërve historike të gjënjështert të Papparegopoulosit, të cilat u publikuan më 1830 si një përgjigje ndaj botimeve autoritare të Fallmerayerit.

Ndërsa historiani i famshëm ishte një prej njohësve më të mirë të gjysmës së parë të shekullit të kaluar, Konstandin Papparegopoulosi ishte më shumë një studjues me fiksim të pabazë, iluzive dhe imagjinare se sa një historian. Përmbledhja e varfer e hamendjeve të tij të gabuara është përkthyer tash se voni në një Greqishte moderne (Shtëpia botuese CACTUS) për të qenë një përhapës edhe më e mirë midis Grekëve të sotshëm, pasi që Papparegopoulos ka shkruar në një gjuhë të fabrikuar artificiale në të resi që s'mund të jete gjuha e një populli.

A.Sabbides, një Bizantolog Grek, për të siguruar pozitën e tij në qendrën e "Kerkimeve" Bizantine të Qendrës Kerkimore Kombëtare, ndjeu si detyrë të botonte një koment pozitiv mbi këtë fallsifikim në të perditshmen "**Kathimerini**". Kjo hedh mjaft dritë mbi nivelin e ultë të kerkimeve dhe veprave që "**studjesit**" Greke kanë ndermarre.

Prandaj është krejt e kuptueshme se pse ata nuk duan të cekin të ma të tilla siç janë bje fjala përhapja se voni e gjuhës Greke midis popuj

ve te Ballkanit te Jugut gje qe ishte ndermarre prej Patriarkanes Ortodokse ne shek, e nente e te dhjete.

Duhen marre ne konsiderate ato çfare Greket refuzojne:

1. Karakteri Maqedonas dhe identiteti i shtetit te mbretit Samuel  
2. Revolucioni Maqedon i Ilindenit dhe lufta e Maqedoneve per pavaresi, bile edhe perpara Lufterave Ballkanike.

3. Fakti i aneksimit te Maqedonise (ne favor te Serbise, Bullgari se, Greqise) si pasoje e Luftes Ballkanike.

4. Qendrimi i Leninit dhe partive komuniste i marre ne fillim te viteve `20 ne drejtim te nje perspektive multikulturore (Maqedone, Vllah Turq, Bullgare, Evgjite, Pomake, Greke, Cifute ) te shtetit Maqedon (1924)

5. Politika kriminale e ndermarre prej shtetit Grek ndaj Maqedonise gjate viteve 1920 dhe 1930: Diskriminimi kulturor; ndrrimi i detyruar i mijera emrave te vendeve, fshatrave, fshatrave te vogla, qyteteve maleve, kodrave, liqenjeve, lumenjeve, zonave historike, provincave, monumenteve; Ndrrimi i detyruar i mbiemrave dhe emrave; perdorimi i fshehte i gjuhes Maqedone, pastrimi etnik i ndermarre veçanerisht pas vitit 1925 kur Greke nga origjina u sollen prej Anatolias dhe u vendosen ne Maqedoni.

6. Perzenja masive e rreth 100.000 njerezve si pasoje e Luftes Civile Greke (1944 - 1949), per kete Maqedonet bashkepunuan me Ushtrine Clirintare Greke (ELAS). Ky qendrim prej barbaresh, u shoqerua me nje humbje te pasurive, pasi toka e shtepia e gjithçka tjeter iu dhane ushtareve te ushtrise nacionaliste, te cilet luftuan kunder Maqedoneve dhe komunisteve si shperblim per krimet e kryera. Maqedonet e perzene u bene qytetare te Jugosllavise por ata kurr nuk arriten te marrin qofte edhe nje vize turistike nga konsullata Greke ne Shkup. Nuk mund te harrohet fakti qe ke ta njerez jane pronare te ligjshem te mijera shtepiave si dhe te miliona hektareve toke ne provincen Greke te Maqedonise.

7. Vazhdimi i tmerrshem i politikës se diskriminimit ne vitet `50 - `60 kur mijera njerez u detyruan perseri te ndrojne emrat; E gjitha kjo nuk e ndrysh dot realitetin e te qenit ende Maqedon ne pikpamje kulturore te banoreve te kesaj ane dhe jo Grek.

Emerimi i peshkopit te qmendur, gjysem te krisur Agustin Kantiotis (Augustine Cantiotis) ne Lerin/Florina ndihmoi vendosjen e nje shteti Kristian edhe me diktatorial ne kete rajon brenda kuadrit te shtetit Grek. Maqedonasit (rreth 1.500.000) jetojne ne te njejtat kondita qe jetonin çifutete ne kohen e Nazizmit Gjerman.

8. Ekzistencen e minoritetit Maqedon ne Greqi.

9. Ekzistenca e gjuhes Maqedone si gjuhe e mesuar ne nje numer un iversitetesh ne bote (Ne Paris eshte themeluar "Instituti Kombetar i Gjuhe ve te Qyteterimit Oriental). Ka edhe kerkime fallse ne Greqi te cilat pre tendojne se kane gjetur "1164 fjale Homerike" ne "dialektin Bullgar".

Politika e neperkembjes dhe fyerjes ndaj ketij vendi dhe populli dallohet shume lehte ne Greqi. Republika e Maqedonise quhej "**Kratidio**" (shtetuc), Maqedonet quheshin "**Gyfto - Skopiano**i" (Magjypet e Shkupit) emer tim ky qe fyen gjithkend"

Duke gene e ndaluar te permendej fjala "Maqedonia" banoreve te saj nuk u thirrej me emrin "Maqedonas" por me mbiemra te trilluar si p.sh "Skaopianos" (Shkupjane). Ekzistenca e shtetit konsiderohej si nje rezul tat i deshires Gjermane per te bashkuar atje te gjitha llojeve te mbeturi nave(!) ose te formonte "nje kanton te magjypeve te Evropes"

Kohe pas kohe, artikujt e botuar ne gazeta dhe programe e TV (kana ali MEGA) perpigen te "Spjegojne" se sa i nevojshem eshte ky shtet per udh en e kalimit te droges. Raportet e gazetareve genjeshtare flasin per insta lime speciale ku pergatitet droga. Te tjere thone se bankat e shtetiti kane rritur fitimet qekurse shume vete mund te pastrojne atje parate e fituara ilegalisht.

Siç shihet qarte, Serbet, Shqiptaret dhe minoritetet e tjera "jane "**te shtypur**" Akuzat me e pabaze eshte ajo qe minoriteti Grek ne ate vend eshte i shtypur. Eshte megjithate e lehte te kuptohet qe keta (100.000 - 150.000) njerez ja ne ata te cilet u perzune nga Greqia me 1949 te cilet urrejne Greket me shume se qdokend tjetet, perkunder faktit qe ata e dine gjuhen Greke te cilen e kane mesuar ne shkollat Greke para vitit 1945.

Shume diskutime jane bere rreth te qenit te ketij shteti nje rre zik serioz ndaj interesave Greke. Sistemi i ri i komunikimit - Rruga qe do te lidhe Durresin e Tiranen me Stambollin nepermjet te Sofies e Shkupit eshte pare si nje rrezik serioz.

Ne se u behet pyetja Grekeve se si mund te jete Maqedonia nje rre zik, politikanet dhe shtetaret e ketij vendi insistojne ne idene e tyre te manipulimit te Maqedonise prej Evropes, Rusise, Bullgarise ose Turqise. Embargoja e pozuar prej administrates se Papandreut tash se fundi ndihmon idealin e izolimit Grek dhe tregon fare qarte se sa e pabaze dhe e rrezik shme eshte per nje vend i cili behet viktime e rrethit vicioz te dogmes se vet te genjeshtert historike.

Pas kesaj analize mund te terhiqen shume konkluzione.

Per shkak te interesave te saj ne zhvillimet ne rajone te tjera, Turqia nuk ben dhe aq kujdes per rajonin e Ballkanit ku çdo vend i ketij te fundit ka aq shume probleme serioze siç jane prania ne to e trubullirave dhe rreziqeve nacionaliste te shkaktuara prej establismenteve te tyre.

Turqia mund te beje shume per te ndihmuar vendet e tjera dhe po pujt e rajonit. Jane shume ata qe shpresojne tek Turqia qe te angazhoje çdo mundesi te saj per ruajtjen dhe sigurimin e paqes dhe zgjidhjen e problemeve qe ata i shqetesojne. Problemet duhet te zgjidhen gjithsesi.



### Rreth autorit

Mohammed Cosmas Megalommatitis ka lindur ne Athine me 1956 dhe ka doktoruar ne Universitetin e Athines, ne Fakultetin e Letersise. Ai ka mbrojtur gradat shkencore ne Universitetin e Parisit, Brukselit, Munsterit, Damaskut, Jerusalemit dhe Bagdatit. Ka studjuar ne tema te tilla si gjuhet antike, historine, filozofine, arkeologjine, fene dhe letersine. Njeh gjuhet Greqisht, Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Rusisht, Italisht, Spanjisht dhe Turqisht.

Megalommatitis eshte lauruar me çmimin Abdi Ipekçi per gaze tari me 1986. Ka pranuar Islamin ne Universitetin e Al - A zharit, ne Kajro me 1993 dhe qe atehere eshte perjashtuar prej Universitetit Pantheon pasi qe protestoi ndaj ideologji se zyrtare Greke. Prinderit e tij kane lindur ne Kastamonu, Turqi. Ai ka shume libra me kerkime dhe ka botuar shume arti kuj ne revista dhe gazeta brenda e jashte Greqise.